

INTERVISTË ME AGIM PAÇARIZIN

Prishtinë | Data: 30 prill 2024

Kohëzgjatja: 147 minuta

Të pranishëm:

- Agim Paçarizi (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Agim, ju lutem nëse mundeni fillimisht me u prezantu, me na tregu diçka për prejardhjen e juaj, familjen?

Agim Paçarizi: Unë jam Agim Paçarizi, kam lind në fshatin Dragobil të komunës së Malishevës në vitin 1955. Fëmijërinë e kam kaluar në vendlindje. Kuptohet edhe shkollimin fillor. Po kam qenë shumë i interesuar për shkollën se atëherë edhe kam fillu shkollën fillore në moshën gjashtë vjeçare. Pas kryerjes së shkollës fillore mandej jam regjistruar në Shkollën Normale të Gjakovës. Në atë kohë mësuesit kishin ni autoritet shumë të madh dhe si fmi i kisha dy kushërinj të mi me të cilët jetonim në ni familje. Njëri kishte mbaruar shkollën normale tjetri ishte në vazhdim të shkollës normale dhe unë ndjeka rrugën e tyre.

Mirëpo nuk e di edhe pse isha shumë herët për të filluar, për të vazhduar shkollën sepse kisha filluar me moshë gjashtë vjeçare, disi më erdhi ni dëshirë që t'mos jem unë msus po t'kam mundësi që të kryj ni fakultet tjetër, ni drejtim tjetër. Kshtuqë bëra kërkesë me bo ndryshimin për vitin e dytë nga shkolla normale në gjimnaz. Kam bo ndryshimin që duhej n'atë kohë në Rahovec. Prej kur kalova me sukses ndryshimin e landëve që duhej nga shkolla normale për në gjimnaz atëherë kam vazhduar shkollimin në Prizren ku e kam mbaru shkollën e mesme në gjimnazin e Prizrenit. Pastaj, kam vazhduar studimet në Prishtinë.

Anita Susuri: Po du edhe pak me ditë për familjen e juaj. Si jeni rritë për shembull? Rrethi ku keni qenë si ka funksionu?

Agim Paçarizi: Ka shumë çka të thuhet për familjen sepse vet viti kur kam lind unë 1955-ta dihet në atë kohë ka qenë aksioni i grumbullimit të armëve. Pas aksionit tjetër që ishte i tepricave, që quhej i tepricave. Në fakt nuk ishte i tepricave për neve shqiptarët po ishte, ku kishte raste edhe millin e fundit që kishin në magje ua merrnin. Vërtetë unë aty kuptova që fmi nuk di të shpjegoj se çka kam përjetu. Po nga ato që kam dëgjuar në odën të cilën në atë kohë pjesën ma t'madhe kemi kalu aty, meqë deri vonë, deri në vitin, nëse nuk harroj me datë, deri më 1972 ne kemi jetuar në ni familje afër 50 anëtarë të familjes.

Fatbardhësisht kushtet materiale i kishim shumë t'mira. Mirëpo të gjitha ato familjet që nifar' forme ishin t'pasura dhe familje t'njohura ishin në sy të armikut pas Luftës së Dytë Botërore, ashtu edhe familja jonë edhe pse babai im, tani i ndjerë, ishte, ka qenë në radhët e partizanëve të atëhershëm në 1945 kur osht' bo mobilizimi i fundit për ndjekjen e forcave naziste nga Kosova dhe Jugosllavia e atëhershme. Përjetimet që babai i tregonte në momentin kur janë mobilizu, kur i kanë mobilizu se me dëshirë nuk kanë shku, u thanë vullnetar sikur rasti i Tivarit që përmendet po nuk ka pasë mobilizim vullnetar po kanë qenë të detyrur.

Ai kur shpjegonte ato peripetitë që kanë kalua, sidomos në momentin kur Shaban Polluzha me Mehmet Gradicën bijnë në kundërshtim me partizanët e tjerë të Lëvizjes Nacional Shqiptare të Kosovës atëherë Fadil Hoxha e të tjerët. Për arsye se filluan serbët të bëjnë masakra prapa shpine, t'i vrainë shqiptarët prapa shpine e tjera. Ai nuk lejon që radhët që udhëhiqen nga ai t'i bashkangjiten radhët tjera për të ndjekur nazistët jashtë Kosovës. Babai e tregonte shpesh se si te Podujeva janë takuar, janë shkëmby, aty duke shkuar radha e tyre drejt Serbisë.

Kurse ata që nuk vazhdojnë mobilizimin ose nuk vazhdojnë ndjekjen e forcave naziste jashtë Kosovës. Ai tregonte shpesh se sikur ta kishim ditur edhe ne ndoshta kish me qenë ma mirë ndoshta edhe ne nuk do t'shkonim. Po fati, ni pjesë e madhe e tyre bashke me të edhe babai im shkojnë. Ndjekin forcat gjermane që ishin në ikje e sipër. Jetesën si e kanë ba, luftën që e kanë ba, privilegjet që i kanë pasë derisa i kanë pasë armët në dorë dhe marrëdhania si ka qenë me eprorët e tyre sa kanë pasë armë në dorë tregon që kanë qenë të privilegjuar në nifar' forme. Ju kanë lejuar çdo gja vetëm që të bashkëluftojnë.

Kur kthehen në Kosovë e shofin që gjithë ato që janë premtu nuk ishin të vërteta për arsye se siç e dijmë në '45-tën në Kuvendin e Prizrenit anulohet vendimet e Konferencës të Bujanit. Ku ishte përcaktu që edhe ishin thanë që populli shqiptar i Kosovës pas luftës mund të deklarohet a do të jetoj me Jugosllavi apo do t'jetoj me Shqipëri. Tani në Kuvendin e Prizrenit anulohen ato vendime edhe njerëzit të cilët kundërshtojnë burgosen ose vriten. Të gjitha këto kur në moshën e hershme i dëgjoja, ishte e vështirë për të kuptuar krejt atë që kishin përjetu familja edhe prindt tanë.

Por, kur n'vitin 1966 u bën ndryshimet në sistemin politik të Jugosllavisë me ramjen e Aleksandër Rankoviçit i cili në atë kohë do të thotë nuk ishte problemi vetëm i shqiptarëve po sigurisht kishte synime tjera edhe në shtetin jugosllav. E ata pastaj e larguan nga funksioni. Te ne në Kosovë nëse s'gabo atëherë ka pasë mundësi me qenë në klasën e pestë apo të gjashtë të shkollës fillore apo të shtatë, nuk e di. Në 1968-tën sa m'kujtohet, osht' shënu 500 vjetori m'doket i vdekjes së Skënderbeut. Edhe m'kujtohet si n'film kur n'shkollë ne disa filluam edhe në ato orët e arsimit teknik që i thuhej të përgaditnim flamurin shqiptar me të kuq me shqiponjen dy krenare.

M'kujtohet ni rast kur e pata për detyrë shtëpie edhe e bëra në shtëpi edhe kur e prezantova para arsimtarit ai erdhi me shumë dashamirësi edhe e pa. Tha, "Uroj që ta kemi sa ma shpejt të lirë..." se e

kisha punu me dorë kshtu, me ngjyrë të kuqe edhe shqiponjën qysh kisha mujtë me vizatu atëherë, dy krenare. Është shumë e rëndësishme të theksohet se te ne oda në atë kohë ka luftë ni rol shumë t'randësishëm. Oda jonë aty meqë ishim familje e madhe nuk ka ndodhë as ni natë që t'jetë pa miq. Të cilët kanë ardhë, kanë vizitu, kanë nejtë me ditë të tëra, me javë e tjera e tjera.

Aty bisedohej në të shumtën e rasteve për të gjithë ato që populli ynë ka përjetu edhe përjetonte. Sepse sigurisht duhet ta dini se familjet e mdha normalisht miqësoheshin me familje t'mdha. Familjet që i kishin n'sy pushteti e kishin të vështirë që me disa familje që ishim ma afër pushtetit të miqësoheshin. Për arsye se nuk e kishin guximin të miqësoheshin me familje që i ndiqte pushteti. Ne si familje e madhe kemi pasë miqësi me familje të njohura të asaj kohe të cilat të gjitha në të shumtën e rasteve kanë qenë n'sy t'pushtetit.

T'u fillu prej familjes Bajraktara të Polluzhës për shembull, të Sadik Osman Hoxhës, të Berishëve, të Radovskit, Rexhep Rremës, të Tojakës kanë qenë nipa tanë me Evdi Kastrati, Hamëz Kastrati. Pastaj babai i mesës Demir Kastrati. Fshati Damanek janë qujtë atëherë do të thotë kryesisht familje t'mdhaja të territorit. Sidomos të regjionit tonë ishin të miqësune me ne. Ata kur vinin n'odë rrinin me orë të tëra edhe për gëzim po edhe për raste sidomos kur kishim t'pane, vdekje. Çdo herë bisedohej për ato që ka përjetu populli shqiptar. Nifar' forme si i ri, do të thotë, ti e ndin atë dhe dalë nga dalë e kupton kush ka qenë ai që ka shkaktu atë skamje te shumë kush. Ne fatbardhësisht kemi qenë familje e madhe dhe kem pasë pasuri.

Kur dëgjoje ti se për shembull në kohën e grumbullimit të tepricave del, detyrohen edhe mure rreth arave të punohen me pjesë të posaçme ku e kanë mshef misrin ose grurin vetëm e vetëm që kur të vijnë në kontrollë mos ta gjejnë në hambar ose në koshe që kanë qenë speciale për grur e misër. Unë habitesha se si, për shembull, kur thuhet po merrej teprica... habitesha atëherë se tani e di se pse osht' bo ajo politikë. Quhej tepricë e në fakt njerëzit i linin pa bukën e gojës. Pastaj, aksioni i grumbullimit të armëve. Ndodhitë e ndryshme, torturat e ndryshme që i kanë ba të gjitha ato bisedoheshin mes njerëzve në oda kur ishte...

Anita Susuri: A i ka ndodhë për shembull babait t'juj ose gjyshit ose dikujt në familje te ju që e kanë malltretu për shembull për armë?

Agim Paçarizi: Te na i kanë malltretu, i ka ndodhë që i ka malltretu por kanë qenë shumë t'kujdesshëm. T'u e ditë që nga fillimi... meqë babai ka qenë bashkë me forcat partizane. N'atë kohë ka qenë edhe nifar' forme janë rujtë nga familjet e mdha. Kanë pasë kujdes që mos të acarohen me familje t'mdha. Duke u nisë nga ajo që ne kemi pasë ni rrjet të familjeve të miqësuar familje t'mdha, t'forta. Ka pasë edhe n'familjen tonë që janë malltretu. Por, për me ju ikë atyne torturave tregonin raste që janë detyru me shitë edhe bagëtinë, me ble ni armë që është kërku me dorëzu. Me qëllim që t'mos të vijë deri te malltretimi.

Ni rast te tepricat që ndoshta do t'kemi rast ta bisedojmë pastaj kur ni mik i familjes tonë vritet para fotografisë së Titos. Atëherë ishte kryetar i Jugosllavisë. Për arsye se nuk i kishte, sipas atyre, nuk i kishte dërguar 25 kilogram tërshanë. Edhe pa asni arsyetim vritet në zyre ku fotografia e Titos ka qenë aty. Ai rast pastaj personi të cilin e vret, vritet nga djali i të vramit. Nuk po e përmendi që të arsyetohet hakmarrja. Po vakti që personi kur e kishte vra ishte n'pozita t'larta dhe e vret n'zyren e tij pa asni arsyetim, nuk dënohet asni ditë me burg, vazhdon të jetoj jetën e tij i lirë, vazhdoj t'ketë funksione vazhdimisht.

Pas ramjes së Rankoviçit, nëse s'gaboju viti ka qenë '67-'68, djali i tij në Prishtinë e vret personin, dorasin. I cili ishte drejtor i postave n'atë kohë. E Ishun Kosovën nëse ju kujtohet Restoranti Union ka qenë atëherë tash nuk e di. Ku osht' Skenderbeu tani, përballë, përballë...

Anita Susuri: Kuvendi, teatri qaty.

Agim Paçarizi: Po. Skënderbeut ku osht' te teatri osht' ai, përpara nashta gjatë luftës s'ka qenë, osht' i renovuar. Aty vritet. Po e përmendi këtë se pastaj vjen radha kur burgoset ky miku jonë i Thaçve të Carallukës. Ikë nga burgu. Unë kam qenë nxanës i shkollës së mesme në Prizren bashkë me dajën tim Nuhi Bytyçi, sigurisht e njihni. Në banesë daja im, dajën tim e bind, vendosin aty se kishte ikë nga Burgu i Nishit dojke me shku në Shqipëri dhe kta e kanë kalu pastaj në Shqipëri.

Familjet do të thotë e mëdha kanë bashkëpunu mes veti, kanë pasë pasuri, kanë pasë mundësi shkollimi të fmise të tyne. Po mentaliteti i tillë ka qenë që nuk, nuk kanë dhanë rëndësi sa duhet shkollës. Te ne kemi qenë, unë i treti, do të thotë kusherini im i parë ishte mbaroj Shkollën Normale dhe filloj me punu si msus. I dyti vazhdonte. Unë i treti n'familje që vazhdova me u shkollu. Kur na lem dhe analizoj e di, tani, po që edhe atëherë e dinim që ishte mundësia të shkolloheshin edhe të tjerët plus edhe femrat po ishte mentaliteti i tillë që ndoshta mos është më mirë që t'punohet toka, të ruhen bagëtitë.

Kshtu pak a shumë fëmijëria ishte kesi soji. Unë kam qenë ni tip shumë kërkues. Kam dëshirë me lexu, kam dëshirë... m'ka interesu çdo gja e re. E di, e di që vullnetin që kisha me lexu, kishim ni bibliotekë në Malishevë. Merrsha librin nga biblioteka dhe rrugës deri në fshat, dy-tre kilometra mundohesha me lexu librin sa ma parë. Nuk e di, ndoshta, s'di a ka pasë ndonjë titull që ka qenë kshtu interesant që është përmend n'shollë e nuk e kam lexu. Kam qenë... e kam dashtë shumë librin dhe kam qenë nxanës i mirë n'shollë fillore. Për këtë arsye ma dhanë mundësinë edhe t'vazhdoj. Kisha edhe tre vllazën tjerë po mu m'thanë, "Vazhdo".

Anita Susuri: Ju vazhdut në Prizren fillimisht në Gjakovë e pastaj në Prizren?

Agim Paçarizi: Në Prizren kam mbaru gjimnazin edhe nga Prizreni pastaj u regjistrova në... e drejta, e drejta me thanë kisha fillimisht kisha dëshirë që o' të mbaroj Fakultetin Ekonomik ose Shkencat

Natyrore. Por ndërkohë u hap si degë e re Dega e Gazetarisë. Ishte konkursi i hapur në fillim të vitit shkollor, që n'fakt unë isha regjistru në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Degën e Kimisë. Por u përcaktova që ta regjistroj Fakultetin e Gazetarisë, gjurnalistikën në atë kohë. Bashkë me dajën e disa të tjerë.

Fati ishte ni konkurrencë shumë e madhe dhe nuk pata mundësi me u regjistru. Atëherë ngela mbrapa me disa ligjerata dhe ushtrime që ishin të domosdoshme laboratorike që bëheshin në Fakultetin e Kimisë. Nifar' forme m'u imponu që ta ndërroj drejtimin dhe kalova në Fakultetin Filozofik Degën e Historisë. Ku pastaj e kam mbaru në vitin 1979. Gjatë studimeve sa kemi qenë nëse s'gabo, nëse s'gabo, vitin e dytë ose të tretë '71-'74 apo '75, ka mundësi. Janë shkrujtë disa parolla te Konvikti numër tre. Edhe në konvikte tjera po në Konviktin numër tre ku banoja unë ka pasë shkru parolla gjithë muret e konviktit. Nifar' forme neve na jpte shpresë që po punohet n'atë drejtim për të pasë të drejtat sikur të gjithë të tjerët.

Në studime ne fillim n'fakt ta gëzojmë pak a shumë nifar', nifar' lirie ma t'madhe sesa përpara. Pas ramjes së Rankoviçit edhe n'vitin 1974 kur ndërrohet Kushtetuta e Krahinës Autonome të Qeverisë së Kosovës n'atë kohë, nifar' forme u fitue nifar' lirie. Ishte ni mundësi të shprehnit ma lirshëm. Filloj bashkëpunimi i Universitetit të Prishtinës me Universitetin e Tiranës. Na vinin profesorët nga Universiteti i Tiranës ligjeronin ktu. Vinin shoqëri kulturore artistike nga Shqipëria në Kosovë. Fillun t'kemi, të krijojmë bashkëpunim me ta dhe përmes letrave, përmes njerëzve që njihim.

Njifar' forme filluam të frymojmë më lirshëm. Në vitin 1979 e mbarova fakultetin dhe të nesërmen m'kërkuan që t'filloj punën si profesor i historisë në Gjimnazin e Rahovecit. Që atëherë ishte vitit i fundit i atij gjimnazit klasik. Do të thotë ishte e fundit klasa e katërt e gjimnazit klasik meqë kishte filluar tani ni sistem, ni reformë ishte bërë ni reformë tjetër dhe shkollat e mesme quheshin si qendra të arsimit të mesëm të orientuar. Mirëpo unë kam fillu në vitin '79 kur ende ishte i fundit i gjimnazit klasik. Bile e kom pasë më është nda ni paralele e nxënësve që janë vitin e fundit, vitin e katërt të gjimnazit. Ata me plan program kanë pasë tri orë në javë histori.

Shumë interesant me përmend, si i ri kisha dalë nga ni rreth nga studimet me ni liri, me ni elan, me ni vullnet që ta çojmë përpara çështjen shqiptare. Meqë e kam pasë profesor Ali Hadrin, profesor ligjerues. Mandej Skender Rizaj, Masar Kodrën e të tjerë. Të cilët sidomos Ali Hadri kohëve t'fundit kur, vitin e fundit kur isha absolvent kishte disa shkrime edhe kundër Svetozar Vukmanović - Tempo,¹ i cili ishte ni komunist, ni historian serb e që kishte nifar' forme kishte deformat ose e kishte shtrembëru të vërtetën për Lëvizjen Nacional Çlirimtare të Kosovës. E Ali Hadri del me shkrime kundër atyre shënimeve të cilat i demanton.

¹ Svetozar Vukmanović – Tempo (1912-2000), udhëheqës partizan malazez, gjatë luftës shërbeu në misione në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Greqi.

Ne kishim rast si student si absolvent që ishim të komunikojmë dhe të bisedojmë edhe më gjerë rreth atyre që ishin aktuale mes Ali Hadrit dhe historianëve serb. M'kujtohet shumë mirë kur në ni rast thotë, "Djema, keni kujdes se historia, historisë nuk iu është vu pikë me neve. Tani ne po përjetojmë", thotë, "ne po përjetojmë ni periudhë ku mundohemi t'i thojmë gjërat drejtë. Mirëpo ju do t'jeni ata që do t'keni mundësi të vazhdoni dhe ta thuni të vërtetën ashtu siç duhet. Sepse..."

E përmendtkë rastin në 1966 kur bie Rankoviçi. Thotë, "Neve na osht' dhanë detyrë partie". M'kujtohet po m'duket sikur po e thoh n'film. Thotë, "Na osht' dhanë detyrë partie që mua si Ali Hadri", që ishte historian, "bashkë me Millan Perka, të bëjmë një libër, ta përgadisim ni libër ku për herë t'parë ne e përmendim që shqiptarët janë pasardhës të ilirëve". Deri atëherë është thënë që shqiptarët janë pasardhës të sllavëve. Na thonte, "Tani ndihem... e ni vetën shumë shumë keq kur deri atëherë s'kemi guxu. Por", nifar' forme e thotë, "edhe tash rrënqethem kur e mendoj që kemi guxu atëherë me thanë". Sepse ishte ni situatë shumë e randë. S'ke guxu asniherë ta thuash të vërtetën për shqiptarët. Për këtë arsye thonte, "Ju i studioni librat që i kemi botu deri më tani por mos mendoni që është vu pikë. Hulumtoni, studioni dhe thuani të vërtetën ashtu siç ka qenë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Deshta me ju pytë pak edhe për jetën kulturore se e përmendet bashkëpunimi me Shqipninë ka qenë atëherë. Ka pasë edhe, për shembull, që kanë ardhë trupa të baletit prej Shqipnisë, trupa të teatrit prej Shqipnisë. Ka qenë ni bashkëpunim edhe domethanë në aspektin kulturor. Sa keni qenë ju pjesëmarrës në këto?

Agim Paçarizi: Personalisht nuk di që ka pasë qytet ku osht' dhanë program nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve të Shqipërisë që nuk kam marrë pjesë. Bashkë me mesën time. Bile në Prizren kur organiohej edhe jipej programi kemi blerë ni buçetë t'madhe me lule, kemi qenë bashkë me mesën. Në shiritin në atë fijongon që i lidhën lulet iu shkruan fjalë më t'mira miradie për ata. Bahria shkon e ia jep...

Anita Susuri: Ia dorëzon lulet.

Agim Paçarizi: Ia dorëzon lulet. Kur përfundon koncerti, shkon i përqafton njëren prej atyne këngëtarëve dhe ia jep si dhuratë. Sigurisht kta kur e kanë pa atëherë... se siguri i shtetit e kuptun pastaj se edhe ata kishin qenë shumë nën vëzhgim. Por, është ni rast që s'di as a e ka përmend ajo po është që m'kujtohet shumë mirë. Nga salla çohet dhe ia jep ni buçetë me lule t'madhe. Ishte knaqësi. Është vështirë të përshkruhet se sa me kënaqësi ne i përcillnim ato ansamble që vinin.

Rasti që e përmenda se unë kom pasë rastin me m'dhanë mësim për arkeologji profesor i nderuar Myzafer Korkuti. Të cilin pastaj e kom has në Gjenevë pas shumë viteve edhe jemi taku e kemi bisedu

gjerë e gjatë për atë. Ishte kënaqësi kur na vinte ora e njëjësive mësimore që na mbanin ligjeratë profesorët. Ndodhte që ndonjëherë edhe te profesorët e tjerë në landë tjera shkonim e merrnim pjesë si student vetëm me i dëgju si flisnin. Kjo do të thotë na bëri që ne nifar' forme ta nijmë vetën gati si të barabartë me të tjerët. Mirëpo kur shihnim realitetin, kishim rast ta vizitonim, për shembull, Beogradin, Zagrebin ose qytete tjera e dallonim meniherë se sa ku jemi ne. Pastaj, te shkolla jo rasisht e përmenda vitin e katërt te ni paralele.

Unë si isha dalë nga studimet me ni... ku kisha studiu, ku kisha ndjekë ligjeratat nga profesorët nga Shqipëria. Nifar' forme kisha lexu edhe kisha pasë rast me e përdorë edhe literaturën që nifar' forme ishte e ndalune po e kisha përdorë për temë të diplomës. Temë të diplomës kisha zgjedhë bashkëpunimin në Luftën Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë dhe Luftës Nacional Çlirimtare të Shqipërisë. Tani hulumtova disa dokumente ku flitej për gjitha ato bashkëpunimin po edhe thyrjet e tjera e tjera. Isha pak ma tepër në ngjarje të gjithë asaj çka kishte ndodhë.

Kur fillova të punoj si profesor, ajo paralele për fat ishin të rritur, ishin, kishte edhe prej atyne që kishin përfundu shërbimin ushtarak po ka shpreh dëshirë që me vazhdu gjimnazin edhe ishin n'shollë. Në plan programin për vitin e katërt të shkollës së mesme të gjimnazit të ma hershëm ka qenë historia ose lufta e mesme çlirimtare e Jugosllavisë. Për klasën e katërt ish dashtë me u mësu kjo histori. Unë si student që e kisha mbaru tani sa e kisha mbaru fakultetin e kisha shku atje. Ni kohë kishim folë për të gjitha ngjarjet e rëndësishme të popullit shqiptar, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, shpalljen e pavarësisë, betejat e ndryshme...

Kur pyes rasisht nxënësit se çka dijnë ata për Skënderbeun, çka dijnë për Kuvendin e Lezhës, a dijnë diçka për pashallëqet shqiptare, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për pavarësi. Më rastis që... ndoshta edhe ajo e nxënësve që nifar' forme nxanësi çdo herë e akuzon profesorin që s'i kanë mësu. "Jo s'i kemi mësu, nuk i dijmë". Për mu ishte e pakapshme. Nxanësi i klasës së katërt gjimnaz dhe t'mos dijë për Skënderbeun. Kuptohet me data, me Kuvendin e Lezhës, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, shpalljen e pavarësisë e tjera. Nuk e di, e niva vetën shumë shumë keq. Thashë, "Po mirë, ju si do të... jeni në vitin e katërt të gjimnazit dhe nuk dini... çka keni mësu?"

Në fakt në plan program i kishin këtë Luftën Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë, sipas plan programit të historisë. Atëherë me pedagogun e shkollës që ishte ni njeri shumë i mirë. Tash ai jeton ende. Muhamer Meta, i kërkova dhe i thashë, "Unë në plan programin si e kemi do ta shënoj në ditar. Por, ni orë nga ato tri orë që kanë kjo klasë ni orë do ta kem për histori nacionale". Kërkova nga nxënësit që secilën javë ni nxanës të përgadis diçka. Një javë për Skënderbeun, herën tjetër për Lidhjen e Lezhës, Kuvendin e Lezhës, herën tjetër për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, pavarësinë e kshtu me radhë. Nifar' forme ta mbajmë te ata në kujtesë se osht' e rëndësishme të dihet për historinë nacionale.

Kur m'rastisi pastaj që m'largojnë nga puna, si duket edhe ato janë gjetë. Se dikush i ka përcjellë se çka osht' ba aty. Viti 1981 zihen, po e thom zihen kshtu në thojza rasisht po nuk ishte rasisht në demonstrata...

Anita Susuri: Po du paraprakisht diçka me ju pytë para se të mbërrijmë te demonstrata. Se m'thatë edhe si student që keni pa parolla e ju kanë inspiru. Po a keni ditë që ekzistojnë këto grupet ilegale që kanë qenë? A e keni ditë n'atë kohë që ka?

Agim Paçarizi: Si student normalisht që e kam ditë, e kam ditë, kom qenë n'rrjedhë se e përmenda familjet miqësitë tona. Fatin e kisha me pasë dhandërr Avdyl Krasniqin. Avdyl Krasniqi ishte burri i motrës time, motra ime ende jeton sot. Kuptohet që kemi bashkëpunuar. Kam qenë në rrjedhë për çdo gja. Jemi takuar shpesh, kemi biseduar shpesh. Por, t'u e ditë se me kënd kem të bëjmë neve na osht' dashtë që t'punojmë me ni konspiracion shumë të thellë. Konspiracioni më i thellë ka qenë kur ne në të shumtën e rasteve kemi bashkëpunu me njerëz që na lidh diçka ose miqësia ose familja. Në rast se njëri zihet të thirren në atë që jo ne jemi miq, nuk kemi diçka tjetër. Por veprimtarinë e kemi fillu qysh atëherë.

Unë kam qenë si student kam pasë rastin me lexu shumë literaturë që vinte nga Shqipëria. Që e përdornim edhe me koleg tjerë, me njerëz tjerë që kishin besimin. Sepse nuk guxonim gjithkund ta shpërndanim dhe e dinim... unë e dija se Adem Demaçi kush ishte. Për arsye se dhandrri im kishte bashkëpunim me të direkt. Kur hasëm na në ato parulla s'ishte befasi, nuk ishte befasi për mua e për disa të tjerë. Por ndoshta për disa po për arsye se jo rasisht e bisedova këtë që pas vitit 1974 në njifar' forme ishte ni liri. U themelu edhe universiteti. U regjistruan shumë student që ishte njëri ndër universitetet thuaja ma të mdhaja ku, nëse s'gabo, kishte mbi 35 mijë student të rregullt. E disa të tjerë... vetëm fakulteti. Plus dhjetë 15 mijë që kanë qenë nëpër shkolla t'larta. Ishte numër i madh i studentëve në krahasim me numrin e popullësisë.

Kishim raste tash kur ne ata që dinim për ato organizata kur të nesërmen e parullave dëgjonim, "Po çka po kërkohet, ne jemi ktu, jemi n'rregull pse çka kërkohet?" Por realiteti ishte se ne t'drejtat në nifar' forme kishin fillu të ipen. Në letër ishin sikur të gjithë popullit e tjerë por realiteti te shqiptarët nuk ishte aty ku duhet. E gjithë kjo shifej te ata që punonin në këtë drejtim dhe jo rasisht ato parulla shënohen në qendrën e studentëve që për koka te ata që merreshin që ta dijnë që nuk osht' çdo gja n'rregull. Normalisht që kam qenë i njoftun përmes dhandrrit.

Anita Susuri: A keni pasë ju ndonjë aktivitet që keni bo?

Agim Paçarizi: Po, aktivitet kam pasë, kam pasë për shpërndarjen e librave, literaturës së ndryshme. Unë edhe vet personalisht m'ka interesu për shembull gjatë studimeve kur bënim punime që duhej përgaditen për një temë gjithmonë e kam përgaditë niherë për jetën dhe veprën e Azem Bejtës. E kom lexu pastaj librin e Ajet Haxhiut për Shotën Galicën. Ato libra që na vinin prej atje, Sylejman Krasniqi e

për të gjitha këto ftyra historike të cilat te ne flitej sipërfaqësisht ndoshta. Kur e gjenin në libër, në roman jetën dhe biografinë gjerësisht edhe mes titujsh ishte kënaqësi që ta lexoje vet po edhe ta shpërndaje te tjerët edhe pse duhej me një kujdes shumë shumë të madh.

Vet normalisht që i kam dhanë, i kam shpërnda edhe të njejtën pastaj e kom vazhdu kur kom fillu me punu si profesor. Për arsye se në studime erdhën edhe dy mbesat e mija. Fatimja dhe Bahrija. Për të cilat e kam nifar' forme e kom meritë që ia kam arritë me bindë edhe prindin e ktyre që t'i lejoj t'vazhdojnë shkollimin se m'kujtohet shumë mirë kur ishin kto n'shkollë t'mesme Fatimja ishte... Fatimja osht' bashkëshortja e Kadri Kryeziut që pastaj është dënu në demonstrata, si organizator i demonstratave të 1981. Ishte ma e madhja. Ajo ishte përpara në gjimnaz pastaj Bahria. Babai i saj vinte shpesh te ne po shihte që ka hall për arsye se edhe n'familjen e tyre edhe te ne nuk përkrahej që të dërgohen femrat n'shkollë.

Një rast pasiqë u nisë me shku për Prizren m'kujtohet shumë mirë, "Eja", tha, "përcillëm ti deri te autobusi", udhtohej me autobus. Unë isha student ende pa përfundu do të thotë fakultetin. "Kam ra n'hall", thotë, "nuk di çfarë t'bëj. Sikur te ju që", fliste për mashkujt që ishin, burrat aty ma t'vjetër baba e mixhallarët e tjerë, "ashtu edhe te familja ime nuk po m'përkrahin për vajza. Kam ra n'hall çka me ba". Punonin vetëm me punë dore që punoni në shtëpi dhe mbanin vetën. Në anën tjetër kishin vullnet për m'u shkollu.

Thashë, "Nëse m'pytë edhe me më dëgju atëherë mendimi im, fjala ime është që lej le të vazhdojnë por bisedo me to që të mësojnë, le të silln si duhet, le të lajnë shembull të mirë edhe për gjeneratat e tjera që vijnë mas tyre. Për arsye se nëse sjellja e tyre do t'jetë e mirë me siguri edhe të tjerat kanë me vazhdu rrugën e tyre". Fati ka pasë edhe disa kusheri t'vet kanë qenë Azemi e Sadi Kastrati që i kanë edhe ata ia kanë thanë t'njejtat fjalë edhe fati vazhdun. E kryen shkollën e mesme vazhdun edhe fakultetin edhe n'kohën kur unë punoja tani si profesor e kisha si obligim moral me qenë në përkrahje të tyre gati vazhdimisht.

Por edhe fillum aktivitetin përmes tyre, shpërndarjen e literaturës sepse e kisha ma lehtë tani se kishe po vi m'i vizitu si janë dhe me ju dhanë literaturën që m'binte n'dorë ose e kundërta. Kishte raste pastaj që punohej në mënyrë zinxhimore. Kish rast që unë e njihsha për shembull Bahrinë direkt ose Avdylin në anën tjetër. Osht' përmend treshja, ndoshta e dini si ka funksionu. Keni dëgju se ju jeni t'reja. Do të thotë unë e kam përcjellë deri te Bahrija Bahrija e ka shpërnda te dikush tjetër. Unë ndoshta s'e kom njoftë se kush osht'. Ose e kundërta. Unë e kom dërgu dikond tjetër, ai nuk ka ditë që ku po e dërgoj. Kemi arritë që literaturën çdo gja që na ka ra n'dorë n'grupet që kemi punu ta shpërndajmë. Pastaj kur filloj botimi i këtyre revistave, Gazeta Çlirimi, Lajmëtari i Lirisë e tjera. Çdo gja që na vinte e shpërndanim me ni kujdes shumë t'madh me kërkesën që t'lexohet dhe të shpërndahet te dikush tjetër pastaj të kthehet.

Si profesor, unë e arsyetoja vetën që ndoshta ka ndodhë, nuk besoj që ka ndodhë, niherë në javë unë kam ardhë në Prishtinë. Nga Rahoveca nga Dragobili kom ardhë në Prishtinë. E kom taku Bahrinë, i kom taku edhe të tjerët dhe kemi shkëmby biseda. Kemi shkëmby literaturë të ndryshme. Kemi bisedu se si të bëhet, çka t'bëhet, tek t'bëhet. Çdo herë me kujdesin që nëse rasisht pyt dikush, kom shku me pa. Ose mu nëse m'pytë, kom shku me pa mesën m'u kujdesë sepse i kom premtu prindit t'saj që do t'kujdesëm. S'po di sa jom i qartë. Ka qenë shumë e rëndësishme që atë konspiracionin, atë punën që e bënë ta bënë në ni fshehtësi shumë t'madhe. Që me asni rast mos t'i japin rast t'kërkojnë që t'mos thonë çka po bojmë.

Anita Susuri: M'thatë që '79-ten keni fillu me punu si mësimdhanës. A keni qenë në Prishtinë me punë a po?

Agim Paçarizi: Jo, unë thashë jam nga fshati Dragobil. Aty në momentin... atë ditë që kam shku kam tregu që kam diplomu të nesërmen nga qendra e arsimit të mesëm të orientuar në Rahovec m'ka ardhë njoftimi që mundem me fillu me punu se ka qenë ni kushti që ka punu si punëtor teknik atje. Sigurisht e ka përcjellë, nuk e di se si. Drejtori m'ka thanë thotë, "Nëse don me punu eja në Rahovec". Kam fillu. Nuk kam qenë në Prishtinë po në Rahovec. Në Prishtinë pastaj kam ardhë vetëm sa m'i vizitu shokët edhe ata që kemi bashkëpunu edhe mesat e mija.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Për fillimin e demonstratave a keni ditë diçka që po planifikohet apo diçka e momentit?

Agim Paçarizi: E drejta që tani unë kam lexu kohë t'fundit, ka shumë shkrime të ndryshme. Por, unë personalisht po them që përveç atij aktivitetit që kemi bërë, që duhet t'bërë diçka duhet të punohet që t'kemi mundësi t'i kërkojmë të drejtat tona, të jemi në nivelin çfare janë këta të tjerët. Datë nuk më kujtohet që osht' përmend që kem me ba diçka. Por, kur fillon reagimi i parë më 11 mars, unë me 12 mars të vitit 1981 rastisi në ato takime t'rregullta që vijsha... kam ardhë n'mëngjes, e kishim ni autobus herët atje për Prishtinë.

Kam ardhë edhe kur vi te konvikti numër dy, ku banonte, ku banonin mesat e mija, e shoh dyrtë ishin të thyera edhe e kisha ni kushti që punonte aty si punëtor n'qendrën e studentëve. Takova para se me taku Bahrinë. M'tha, "Dje kanë fillu demonstratat", "Hajde përhapj koftë". Dulë pastaj Bahria edhe Fatimja dhe po m'tregojnë po se si ka zhvillu ngjarja. Kjo është e datës 12 mars të vitit 1981. Do të thotë, unë rastësisht atë ditë, sikur që shkoja për çdo javë gati vija në Prishtinë. Atëherë është bisedu edhe osht' pa se si është zhvillu krejt ngjarja dhe osht' bisedu për 26 marsin.

Deri me 26 mars kuptohet që jemi taku. Jemi taku në Prizren, kemi fillu përgaditjet e se çfarë parolla të përdoren. T'mos përdoret diçka në kundërshtim me atë që janë thanë m'u përdorë, e tjera. Kemi

përgadit vet n'shtëpi të hallës aty bashkë me Bahrinë. Me 26 kom ardhë, kam qenë pjesëmarrës direkt i demonstratës. Fati im kur fillon rrethimi që vijnë nga jashtë kishin ardhë nga komunat e tjera. Vijnë policët nga Malisheva dhe Rahoveci. Njëri nga policët... donim ne me dalë n'pjesën me vazhdu për poshtë anena... flitej që erdhën profesor me bisedu me studentët, erdhën edhe përfaqësuesit politik. Azem Vllasi, Pajazit Nushi ishin aty e tjerë. Nuk m'kujtohej me emra se kush. Flitej për shpërndarje e çka kërkoni.

Po kishte momente kur filluam ne i gjuanim forcat policore. Ajo pjesa përmbi qendren e studentëve ka qenë ni... punohej, punishte, ni punishte ku mbaheshin ndërtime. Kishte plot guraleca e zallë, i gjuanin me ato. Ata pastaj filluan me na gjujtë me gaz lotsjellës dhe ngjiteshin deri lartë përmbi këtë sallën tani që është 1 Tetori, a si quhet kjo salla? Po. Kur ngiheshim frymë edhe e kalonim pak atë efektin e gazit lotsjellës ktheheshim prap dhe gjuanim me gur.

Ni moment kur vendosëm me dalë nga rrethimi dhe n'anën tjetër me vazhdu te poshtë në rreth ishte ni kordon i policisë. Fati qëllon ni polic nga Malisheva i cili m'ka njoftë. Se kam punu do të thotë. Përveç në Rahovec kemi pasë qendrën edhe në Malishevë dhe Ratkoc. Kemi qenë shumë të privilegjuar. Atëherë si kuadër sigurisht deficitar kshtu që kemi qenë të pakët me diploma të universitetit. Kemi pasë dy vetura nga qendra që na merrnin në shtëpi na çonin në shkollë prap na kthenin në shtëpi. Kanë qenë kushtet t'mira marrë sipërfaqësisht. Po kur e dinim se çka, ku osht' populli shqiptar me të tjerët, ne disa s'ishim t'knaqur me atë.

Polici m'njeh dhe ata e kishin pasë secili kush dilke nga rrethi me kërkun një dokument identifikimi për me ruajtë atë mandej me pasë si dëshmi. Mu m'thotë se, m'duket kshtu si n'film edhe tash. M'thotë, "Kadale mrapa janë të Rahovecit. Mos le dokument", m'thotë ngadale, "mos le dokument këtu thuj që s'ke ose ikë tjetrën anë, akoma nuk është rrethu". Ksi soji edhe nuk guxon me lëvizë. Unë e marr të dy mesat edhe kthehem. S'kam dokument edhe... "S'ke dokument nuk munësh me kalu", "N'rregull". Kemi dalë tani përmi qendrën e studentëve kah ishin t'u u ba disa punime të këtyne konvikteve tjera të studentëve e rrotull e pastaj kemi dalë andej.

Në mramje dikur kemi vazhdu rrugën me ni autobus për Prizren. Ku kemi vazhdu mandej me shpërndarje të parullave. Shkrumje, shpërndamje nëpër ato rrugicat aty. Ishte nifar' entuziasmi ku e shifshe ton atë masë që e kundërshtonte policinë që ndoshta dikush nuk guxonte, nuk kishte guximin as ni fjalë t'keqe me thanë. Tash ne e gjuanim me gurë ose shprehnim parolla të cilat na interesonin. Ishte nifar' guximi në vetëvete që t'shprehesh. Sepse mendojshe që ndoshta do t'na bashkangjitet e gjithë popullata edhe nifar' forme të kërkohen ose t'fitohen të drejtat që i kishin të tjerët.

Anita Susuri: Zoti Agim, e përmendet 26 majin. Osht' ni datë që...

Agim Paçarizi: 26 marsin se edhe une ndoshta janë ni distancë nga 12 deri me 26 por me 12 mars bisedohet pastaj që me 26 t'jetë ni demonstratë ma e madhe. Për arsye se atë ditë ishte caktuar që

shtafeta e Titos që ishte ni, ni parakalim, për çdo ditë që bëheshin nëpër vende të ndryshme. Atë ditë kalonte nëpër Prishtinë. Qëllimisht ishte kërku që atë ditë të bëhet ni organizim i tillë. Ajo m'ka shtyrë që edhe unë t'jem me 26 këtu. Sepse nga shkolla ta lë mësimin në shkollë dhe të marrë pjesë në demonstratë, logjikisht kuptohej që ishte e qëllimshme.

Se ndryshe kur je student vala e demonstratës të përfshin dhe i bashkangjitesh. Ndoshta nuk je përkrahës i saj dhe nuk don t'marrësh pjesë por vala të përfshin. Unë kam ardhë sepse është bisedu, është thanë që këtë do t'bëjmë. Sepse ajo ditë ishte shënue që t'pengohet nifat' forme dhe të tregohet që nuk ka vllaznim bashkim te ne me këto derisa s'jemi t'barabartë.

Anita Susuri: A ka pasë edhe ma shumë për shembull polici? Sigurisht ka pasë ndoshta edhe u prit që ka me ndodhë diçka. Qysh e keni pa ju qytetin për shembull?

Agim Paçarizi: Atë ditë ka qenë fillimisht, se unë kam ardhë shumë herët, polici edhe rrugës janë ndalu n'autobusa kanë shiqu por nuk osht' hetu kumeditë sa. Derisa janë grumbullu studentët në mesin e qendrës së studentëve. Në mesin e qendrës së konvikteve aty. Kur osht' ngritë ni binë, janë improvizu kanë shpreh pakënaqësi, osht' kërku që t'mos përdoret dhunë e tjera. N'anën tjetër nga profesorët është kërku edhe nga politikanët që t'mos veprohet, të shpërndaheni sepse kalon shtafeta e tjera. E qëllimi kuptohet që ishte që t'mos lejohet, t'pengohet ajo.

Policia ka ardhë sidomos pas dite. Unë pastaj kam pa sa kom pa por nuk e kam ditë që ata kanë qenë polic t'gjithë. Përveç atyne specialeve që janë dallu me atë veshjen speciale. Polic ka pasë gjithkah, gjithkah, gjithkah. Por pastaj të nesërmen e në vazhdim me kolegë, me ata që kemi, që kanë qenë ende në studime e që jemi njoftë ma mirë kanë tregu se çka kanë përjetu. Dhunën që është përdorë ndaj studentëve, sidomos ndaj femra po edhe studentët mashkuj pastaj kur i kanë detyru të gjithë me dalë me durë të lidhura pas qafe dhe i kanë detyru m'u ulë dhe i kanë rrah me gërrpaç, tmerr, tmerr. Mandej se si i kanë grumbullu në stadionin poshtë atje. Gjitha këto pastaj kur i kemi bisedu me të tjerët.

Përndryshe, unë, e imja që kam përjetu ka qenë ajo gjumje që kemi ba n'drejtimit të policisë pasiqë nuk jemi shpërnda dhe kanë fillu me na gjujtë gaz lotsjellës për me u shpërnda. Largimi ynë bohej larg tyne dhe sa me marrë vetën nga gazi lotsjellës e pastaj ktheheshim e gjujshim prap. Pas dreke kur e gjejmë ni vend me kalu ku s'kishte polic e me u bashku e m'u lidhë me turmën tjetër me vazhdu deri te ku ishte atëherë Komiteti Krahinor, a si i thonin. N'fund në mramje rruga për Prizren.

Anita Susuri: Pastaj ka qenë edhe 1, 2 prilli...

Agim Paçarizi: 1, 2 prilli ka qenë gati gjithë popullor. Ajo ishte edhe ma madhështore. Ishin rrjedhojë e kësaj që vazhdoj. Unë kam vazhdu me punën në shkollë. Por, është hetu meniherë që ka vëzhgim ma të theksuar. Përveç atyne policve ka pasë edhe njerëz që ne i kemi njoftë pak a shumë që janë

bashkëpunëtor të tyne që e kanë vëzhgu punën që po bohet. Kur vjen n'fund t'prillit ishte festa e majit, nuk e di sa ditë kishte pushim. Ne gati në të shumtë ne kohës ishim pastaj me Bahrinë dhe të tjerët në lëvizje për parolla, për organizim.

Policia kishte vazhduar burgosjen edhe grumbullimin e ni pjese t'madhe të intelektualëve me ni qendër të caktune në Lipjan. Unë nuk kam ditë kurgjo. Kemi qenë në aktivitet me Bahrinë nga Prizreni prej shpisë t'tyre pasi natën kemi shpërnda aty këtu parulla edhe i shkrujshim... u munojshim m'i shkrujtë jo me shkrimin çfare e kishim po e përdornim këtë vizoret që qëllimisht nëse na zanë t'themi që nuk e kom shkrujtë unë, nuk di kush e ka shkrujtë e tjera e tjera. Hypi në autobus, ka pasë ni autobus që udhëtonte në mëngjes shkonte nga Malisheva për Prizren e në mramje rreth orës 03:00 e diçka nisej prej Prizren për Malishevë, Dragobil e në Malishevë.

Unë hypi n'atë autobus. Osht' shumë interesante tash për atëherë habitem se si kemi qenë, si... osht' edhe e dhimbshme, si kemi qenë aq bashkëpunues. Po flas në të përgjithshmen. Populli jonë me armikun. Unë Dragobili kur kam zbritë në stacionin e autobusave ka nja ni kilometër prej aty deri te shtëpia ime. Rugës e takoj ni koleg timin që kemi qenë në studime bashkë. M'thotë, "Agim, ti e din po te shtëpia janë t'u t'kërku policia". "Ti e din", do të thotë nëse je, ke bo diçka, dije që janë t'u t'kërku. Unë derisa kom shku te shtëpia, ni kilometër, autobusi nga Dragobili deri në Malishevë derisa ka shku autobusi atje dikush nga autobusi ka shku meniherë në stacion të policisë ka tregu që Agimi erdhi.

Dy tri herë kishin shku policia me m'kërku te shpija. Baba ni rast ish nervozu ju kish thanë, "A dini çka? Osht' festa e 1 majit, 1 majin e feston krejt Jugosllavia. Ai osht' ka pushimin e vet ku osht' nuk di. Kur t'vjen i tregoj. Ejani kur t'vjen. S'keni nevojë me ardhë te shpija se po m'i frikësoni familjen". Kur hi në oborr unë, e hapi derën e odën, shoh aty kishin ardhë e gjithë familja. Kusherinjte, dajte. Sepse disa herë kishin ardhë policia dhe çka kanë ardhë? Çka po t'kërkojnë e tjera. Thashë, "Përhajër qoftë, dihet pse. Fundi fundit nuk kom bo ndonjë veprim të turpshëm për juve", "Mirë", tha baba, "veç dije që ka tre katër herë që po vijnë".

Unë ende pa u ulë si duhet me u rahatu, ata me ni veturë t'vogël erdhën edhe, "Hajde, kemi urdhër". Erdhën dy polic. "N'rregull". Më nisën për Rahovec. Ndërkohë në Rahovec e kishin nisë ni veturë tjetër me më marrë. S'e di sa e dini atë teren. Atje në maje të bjeshkës të Zatriçit, rruga që shkon për Zatriç ni veturë tjetër. U shkëmbyn mes vete. Thanën, "Ne kena ardhë me marrë". Më morën mua ata tjerët. Unë isha i veshun tamon siç kisha qenë. Kom pasë princip nisoj me u veshë me kat. Se e kërkonte edhe profesioni. Nga aty më fusin me ni dhomë nën shkallë në stacionin e policisë të Rahovecit.

Rastis aty me qenë ni nxanës i imi të cilin e kishin malltretu aq keq. Shifej... tani osht' dëshmor i ndjeri, osht' vra në luftën e fundit. Qemail Bytyqi. Kur m'pa mue profesorin aty, u habit ai. Unë isha pa pranga, isha civil kur hyna mbrena. Ata e mbyllën derën jashtë edhe kumeditë se si. "Çka osht' problemi?" "Na kanë zanë", tha. Me atë e kishin zanë edhe vllaun tim që ishte maturant i gjimnazit. Tash përveç asaj që ne ishim vllazën dhe normalisht ai e dinte pak a shumë se çka bëja po meqë isha maturant, unë

profesor, pak a shumë e ndinte vetin pak ma të privilegjun. Me disa koleg aty, me disa nxanës, shokë të tjerë e kishin organizu ni demonstratë.

Tash po i thom unë, “Çka? A t’kanë malltretu?” “Jo, jo profesor”, “Po kjo nuk osht’, s’ke bo marre kurgjo, punë e madhe. Nuk ke nevojë me u ni keq”. U qetësu ai pastaj. Nuk shkoj as dhjetë 15 minuta m’dha leje. “Dil jashtë”. Më morën. Tash më nisën për Prizren. Nuk kisha se çka ku. Asni fjalë kush nuk e folke me mu veç, “Eja”. Në fshatin Bollacërkë, ni fshat aty pa dalë në Xërxe atje, ni automjet me kto që janë me kto rrjetat i posaçëm i policisë e nalën rrugës këtë veturën që ishin t’u m’dërgu atje. M’kalun edhe aty. Ka qenë edhe dikush tjetër aty po nuk e di se kush ka qenë. A ka qenë ai dikush që e kanë marrë a bashkëpunëtor i tyne nuk e di.

Prej aty m’kanë çu në Prizren. Kur hyjmë në Prizren nuk kemi hy ka dera kryesore po m’kanë çu nga ni derë kah burgu edhe ni sallë e madhe. Kur futem n’sallë e shoh plot të ri e të reja të veshura kuq e zi, pantolla, këmisha. Se ku i kishin hasë... me plis t’bardhë ose me shallë kuq e zi. Ku i kishin zanë krejt i kishin fut edhe i kishin lanë aty dhe n’pritje t’gjitha. Mu... kalum andej pari edhe m’çun n’zyre naltë. Askush s’vjen me m’pytë veç më mbyllen mrena. Deri dikur kah mesi i natës. Kah mesi i natës ka ardhë njani, nuk osht’ prezentu se kush ka qenë.

M’pyt për Bahrijen, m’pytë për Kadriun, m’pytë për Fatimen, m’pytë për kusheri t’mi, m’pytë për do shokë. Veç pyt, “A i njeh? Ku janë? Si janë?” Sipërfaqësisht, para se me m’pytë kush janë tek janë. Del jashtë. Pas pak vijnë, “Hajde”, thotë, “me neve”. Më futën me ni dhomë ku kish armë andej. E mori armën në prezencë timen po e mbush atë karikatorin po e fut në automatik. “Zgjati durët”, m’i vendosi prangat. Polici ni inspektor që ishte civil, shoferi... edhe tani po m’kalojnë nga e njejta rrugë nga m’kishin pru, nga e njejta sallë. Që n’momentin kur i pashë tani se kish prej atyne nxanës t’mi që më shihnin me durë t’lidhura. E nijta ni lehtësim shumë t’madh sepse gjatë kohës sa pritsha atje lart, unë isha i veshur me kat civil. Policët ishin me mua. Ne hyjmë. Nifar’ forme nuk nijsha frikë sepse...

Anita Susuri: Sikur ti me bashkëpunu...

Agim Paçarizi: Po. Menoja thashë, sigurisht ata nxanësit kanë me mendu që jam bashkëpunëtor i tyne. Kur dola tani i prangosur u hetu meniherë te fmitë. Se sigurisht kanë pa edhe ndoni tjetër se kanë marrë edhe naj tjetër. Kjo ka ndodhë pasi që pjesa ma e madhe e profesorëve dhe personave që kanë pasë t’njejtin vendim sikur për mu, i kanë çu në Lipjan. M’kanë marrë pas gjysës t’natës me ni veturë, nëse s’gaboje ka qenë ni pezho 604. E fundit që kishte mrri atëherë në Kosovë, e policisë. Polici, inspektori, shoferi edhe unë.

Prangat kah shkonte vetura, ishte natë, nuk kishte vetura tjera. Nuk disha a po m’çojnë te shpija e hallës ku ishte mbesa Bahria. A po m’çojnë te shpija e kusherive që m’i përmendën, a po më dërgojnë te shpija e Kadriut e që ai ishte student kha në Prishtinë. Do shokë që m’i përmendën... nuk isha n’gjendje se s’disha. Nuk u ndalëshin aty. Kur vazhdun te Duhla përpjetë. Nuk m’çun te shtëpia ime në

Dragobil thashë sigurisht në Prishtinë te shoktë dikun. Ku ta di unë. Kto rrugët e grykës së Carralevës me kthesa, vetura shkonte shpejt. Pak që lëvizi dora prangat hynin edhe më thellë në mish. Veç kur e kom pa vetën u nalëm para Burgut të Lipjanit.

Më vendosën aty. Në hyrje po i drejtohet atij, “A t’ia hekim prangat?” Ai ishte lodhë, ishte lodhë shqiptari t’u pa njerëz të lidhët të shkollun t’u i pru aty. Me ni ton shumë të ashpër ju tha, “Zgjidhe more, qysh s’po ju vjen marre”. Më kanë hjekë prangat dhe m’kanë fut me ni dhomë. Kur hy brenda, m’duket se ishte ulë kamë kryq, ni msus nga Podujeva. Babai i Xheladin Rekaliut që ka qenë i dënum për demonstratat e 1968. Ky ishte Jetish Rekaliu, mësus. Ni burrë i gjatë, ni burrë i... po m’thotë, “Mirë se erdhe”. Unë isha shumë i ri në krahasim me moshën që kishte ai. Sa kisha dalë prej... në ‘79-ten kisha mbaru kisha fillu me ‘81-ten, isha i ri domethanë. Isha 26 vjet. “Mirë se erdhe”, thotë, “dhe mos ke merak se burrat ma t’mirë i ke këtu”.

Aty n’dhomë ishte, përveç atij, ishin edhe dy vëllezërit Brahaj. Seladin edhe Qemail Braha. Ishte ni profesor gjithashtu i historisë që punonte, nëse s’gaboju që e kishin largu nga arsimi punonte në shtyp shkronjë, Muhamet Shatri. Ishte ni poet m’duket, Rani Tuda. Se di si emër a ju kujtohet. Pastaj në dhomat tjera ishin, t’nesrit kur dolëm, ishin Kadri Halimi, ishte Sadik Bajraj që ka qenë kryetar komune ka qenë ni kohë. Ishin Eqrem Kryeziu që shumë i respektuar ishte nga Pagarusha që e njihsha herët, bashkë me vllaun e tij. Dhe dy kusheri t’mi. Ni kusheri i afërt Sahit Paçarizi nga ni tjetër dhe ni nxanës i imi, Habib, që ishte nxanës i imi. E të tjerë afër 100.

Në Lipjan na majnë gati ni muj, ni muj. Po ka qenë interesante ni ditë kur... [nuk e di] sa e kanë përmend të tjerët apo sa keni dëgjuar. Ka qenë ni grup i nxanësve të Podujevës që thuhej se kanë, nifar’ forme i kanë çarmatos ni patrullë të policisë. I kishin pru ata në Lipjan. Ne kishim kohën kur dilnim në shëti, shëtitnim në oborrin e burgut. Kuptohet durët mbas shpine, mos me bisedu me njanin tjetrin, rresht për dy e tjera. Kur shohim nxanësit i kanë qit’ nisoj me shëtitë. Disa nga, ndër ta ishte edhe Jetish Rekaliu. Kishin qenë mësues të nxanësve që parakalonin tash në oborrin e burgut. Ne nga disa, tash nga grilat që ishin aty, dritaret ishin t’hapura. I kanë thirrë me emër. Fillun me ju dhanë nifar’ forme kurajo.

Ata edhe si fmi dikush me buzëqeshje t’u shiqu knena, dikush kumeditë kanë folë naj fjalë që s’e kom ndëgju. Ni polic prej, shqiptarë se ata mrena ishin shqiptarë, i bëri rresht siç ishin dhe ju tha, secilit po ju jep nga një pendrek, kërrbaç n’dorë. Reagim i mësimdhënësve ishte i tmerrshëm pastaj. Sidomos ai që kisha n’dhomë, Jetishi, i ka kap grilat edhe po e shan e po fyn atë, “Idiot, i poshtër. Si ke guxim ti me na rreh nxanësit para sysh?” Ai edhe i pa pjekun ai polici. Tha, “Kujdes”, tha, “se me ardhë atje brenda ta boj ma zi se ktyne”. Ai s’e di se kishte atë mundësi m’i hjekë grilat se aq fortë edhe shajti i bërtiti. “Ti je i lig me rreh fmi para sysh”.

U futën brenda ata. Morëm vendim ne tash, dolëm n’dhoma tjera... se kati, kishim dhomat, dhoma prej dhomës mundeshin me bisedu, me u taku, me lujtë ndonjë lojë. Na patën mundësu edhe ni

tranzistor t'vogël dikush e futi përmes dritarës e kishte do t'ri që ishin dënu e kishin liri pak ma tepër. I përcillnin lajmet dhe bisedum. Tha, "Nuk dojna me dalë tash. As nuk do t'dalim me marrë ushqimin në drekë, as nuk do të dalim me marrë ushqimin derisa t'na vjen ni përgjegjës me bisedu për veprimin e këtij polici". U morëm vesh edhe me katin nalt dhe nuk dolëm.

Kah mramja ka ardhë drejtori i burgut. Jemi hy me ni sallë të gjithë. Na ka folë për, "Osht' e mirë e ju', ju jeni, rrini me ni vend të qëndrun osht' mirë për shëndetin e ju' me dalë me lëvizë e me marrë ushqimin". Atëherë u çu ai Jetishi dhe Kadri Halimi si ma i vjetër se ishte si ma i vjetri thanë, "Ma së pari tregona se çfarë statusi kemi? Jemi të burgosur? Jemi në hetime apo çfarë jemi? Apo jemi të dënuar? Tjetra, pse me na provoku me ni formë të tillë me nxënësit me i rreh para..." Atëherë ai e shpjegoj, tha, shumë njerëzishëm. "Dine", tha, "që edhe neve na osht' drejtu kryesia e Kosovës nga Sekretariati i Punëve të Brendshme që t'i përgadisim 100 shtretër për disa ditë. Nuk kemi kufar' t'dhana tjera përveç atij vendimi që keni ju".

Ne e kishim ni vendim model të cilin ishin plotësu vetëm emrat e secilit. Shkrunte për shembull, me këtë numër të këtij vendimi, të kësaj date kryesia e Krahinës Autonome të Kosovës, Sekretariati i Punëve të Brendshme urdhëron filan fistekun profesor ose drejtor ose çka ka qenë që të qëndroj në vend të caktuar prej kësaj date. Pa ditë që deri kur. Vendimin që i kishim shkruanin që vetëm është marrë ni vendim për shkak të rrethanave të krijuara. E kom pasë me veti po kom harru me marrë. Po sigurisht e keni që ju ka prezantu dikush. Nëse doni mund t'ju përcjelli me email mandej. Ka qenë model shabllon që thuhet për të gjithë.

Nuk dinim. Ai tha, "Nuk di se sa. Neve na kanë thanë për pak u bën gati ni muj, ndoshta shkoi e shumta mbeti me pakëta". Me këto fjalë nifar' forme, "Nuk do t'ketë ma rast të tillë, personi që ka qenë do të suspendohet menjherë". Vërtetë s'e pam ma. Kah fundi i majit vinin, i merrnin me radhë. Dikur më erdh radha edhe mu. Dy civil që ishin inspektor, që nuk e di se kush ka qenë, nuk... as emra s'kanë prezantu as nuk e di sot e kësaj dite. Kanë kërku jo pse jo andej jo këndej po sipërfaqësisht pa hy në detaje.

Kanë thanë që do të liroheni po kujdes për sjelljen tuaj. Kaq. M'kanë liru, flas për veti, edhe disa tjerë që i kishin liru i kom taku pastaj në stacion të autobusave ku u takum. Me ni autobus që ka ardhë prej Prishtine kam shku deri në Prizren. Aty kam bujtë te halla edhe të nesërmen mandej kam vazhdu për Dragobil.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Thatë që i lirin pastaj pas këtij izolimi, po qysh vazhdoj jeta ju'?

Agim Paçarizi: Bash nga ai muji i izolimit shumë shkurt pas dhjetë dite po m'duket, dy jave, ma sollën thirrjen për me shku në shërbimin ushtarak. E drejta, unë kam qenë i interesuar që të shkoj në

shërbimin ushtarak për oficer rezervë. Ashtu e kom pasë të caktune. Por, pas këtyre ngjarjeve si duket ata nuk ishin të interesun me m'dhanë mundësi me shku n'atë drejtim dhe më vijnë ftesën për me shku shpejt e shpejt ushtar ku më caktuan që të shkoj në Prilep.

Të flasësh pastaj për peripetitë, për të gjitha ato që ndodhin gjatë shërbimit ushtarak, osht' vërtetë ni përjetim shumë i randë. Për arsye se që n'ditën e parë n'momentin kur takohem me eprorin tim, e shoh... fati im në dokumente përcjellëse që kishin dërgu, në kopërtinë e kishin shkrujtë serbisht "*Bio je u zatvoru 30 dana*", që kur e përkthejmë shqip thotë, "Ka qenë në burg 30 ditë". Unë rastësisht e lexova, e pashë. Isha përballë me eprorin. Ai ndër tjera po pytë, "Kush je? Si je? Tek je?" Andej këtej. Tha, "S'op tregon drejtë se ti ke qenë n'burg". Meniherë filloj me atë tonin e ashpër.

Unë i qetë, e disha që duhet me kry dhe duhet me pasë kujdes për arsye se dihej si kishin fillu diferencimi e tjera. Thashë, "Jo, s'osht' e vërtetë s'kam qenë n'burg", qetë unë, "s'kam qenë n'burg", thashë. "Unë i kam t'dhanat që ke qenë n'burg", "Jo nuk kam qenë n'burg une. Kam qenë në izolim", thashë, "jo n'burg". Për m'i tregu që edhe... po osht' shumë interesant edhe ni gja ta përmendi. Diferencimi që filloj meniherë pas 1, 2 prillit, sidomos kur filloj marrja e njerëzve n'rrugë me familje, me fmi. Kapja pa asni urdhër, prezentim t'urdhërit me shkrim që kemi urdhër me t'marrë po veç i kanë kap në korzo t'u shëtitë me gratë e tyre ose me burrat e tyre se ka pasë edhe femra. Para fmive në mënyrë të vrazhdë.

I futnin në izolim. Futën tmerrin te ni pjesë e madhe e popullsisë. Kur kam dalë pastaj nga izolimi, m'tregon vllau i madh i cili thotë se ni javë nuk e kemi ditë se ku jeni, "Ni javë ditë nuk kemi mujtë me marrë informim se ku jeni, s'na kanë tregu policia". Po çka osht' ma interesante, vllau që ishte maturant e dënojnë me dy muj me procedurë të shpejtë për kundërvajtje kinse si organizator i demonstratave. Kurse mua m'çoj në izolim. M'thotë, "Kur hypsha në autobus me shku me marrë informatë dikund akush nuk guxonte m'u ulë në karrigë me mua. As të afërmit, as të fshatit". Ishte... kuptone se çfarë diferencimi filloj t'bëhej.

Meqë e dijsa që ishte shumë situatë e ndishme delikate u mundova që sa ma i qetë të sillem. Thashë, "Unë nuk kam qenë n'burg, ju ndoshta e keni informatë por është e gabuar. Unë kam qenë në izolim dhe s'kam qenë fajtor tani jam ardhë me kry shërbimin ushtarak". Po vazhdojmë aty s'i osht' edhe si ushtar. Kuptohet që ishim në vëzhgim të pandërprerë të sigurimit të msheft ushtarak, sigurimit të shtetit. Mirëpo ne kishim disa lidhje aty. Gjetëm disa njerëz që mund t'bisedonim lirshëm por edhe interesoheshim për gjendjen jashtë.

Është interesante me përmend rasti kur mbahej Kongresi i Punëve të Shqipërisë. Kur Shqipëria e ngrit zërin kundër Jugosllavisë për dhunën që e përdorë ndaj studentëve dhe popullsisë të popullit të Kosovës. Kapiteni i cili m'kishte halë në sy dhe mendonte t'më çonte në burg thotë, "A ke dëgjuar çfarë kërkon Enver Hoxha yt?" Ai thotë serbisht po unë p'e tregoj shqip. Unë qëllimisht me ju kundërvu se

m'dha shkas me reagu thashë, “Sikur të ishte Enver Hoxha im unë s’kisha ardhë me kry shërbimin ushtarak këtu po çka je ka thu? Çka po flet kështu?” Thashë, “Po mirë, do t’flasim ma vonë”.

Më rastis në oborr me kalu përgjegjësi i komandës aty i kazermës. Dal përpara e përshëndeti dhe i drejtohem pak me ton të rrepët që ai ishte komandant i kazermës por... Thashë, “Unë nuk di si t’ja dal në skej me kapetan Pralicën”, ishte ai, kapiten. “Pse?” Ai u habit. Ai ka qenë i vjetër dukej si njeri i arsyeshëm por mu m’dukej secili që e ka atë emrin e mbiemrin sllav i futsha me ni thes. Thashë, “Ai në vend se nëse jam në rrugë të gabuar me m’sjellë me m’thanë eja se ktu osht’ rruga, ai nga rruga po m’don me m’qit’ pa rrugë”, “Pse?” Po i them tekstualisht, “Erdhi dhe po m’thotë, ‘A dëgjove çka po kërkon Enver Hoxha yt?’ Me qenë Enver Hoxha im”, thashë, “unë pse me ardhë në shërbim në Jugosllavi këtu, isha shku në Shqipëri atje”, “Çka?” U nervozu ai.

Po hy tash në zyre i trimnun thashë, “Dil se po të thrret ai”. Desh u çmend. “Qysh guxon ti me dalë para këtij?” Se ajo për me u taku ti me eprorin tjetër duhet me marrë leje nga ma i vogli e me radhë. Thashë, “Shko se po të pret”. Afër ni orë e ka majtë gaditur t’u nejtë përpara, çka i ka thanë nuk e di. Po do të thotë isha shumë i kujdesshëm për arsye se kom mujtë me përfundu sikur shumë të tjerë që pastaj kemi dëgju që janë burgosë o’ kanë dashtë m’i helmu, o’ kanë dashtë gjithë ushtarët në kuzhinë e tjera. Mirëpo fati, fati kam kalu t’u ju falënderu asaj kujdesit.

Edhe pse nuk shkonte java pa m’kërku, “Pse çka u ba?” “Pse nejte aty? Pse e takove këtë? Pse po flisni shqip?” Plus kanë angazhu edhe oficer shqiptar se kemi pasë edhe oficer shqiptar. Për fat t’keq ata kishin qenë, njani prej tyre kishte qenë i sigurimit të shtetit ushtarak. Po për mos me zgjatë se osht’ vërtetë ka shumë çka të thuhet atje për atë periudhë. Në momentin e fundit kur më bijnë rrobat civile për me dalë nga ajo dhe kishin ardhë me m’prit mu atje te kazerma thotë ai i sigurimit m’kërkon me shku me m’taku. Me m’provoku thotë, “Kemi gabu me datë ti duhesh me nejtë edhe ni ditë nuk mundësh me shku edhe pse t’kanë ardhë me t’pritë te dera. Ti duhesh me qëndru edhe ni ditë se janë ditët...” 15 ditë m’patën dënum e nifar’ paraburgimi quhet.

Ka shumë çka të thuhet për atë periudhë por po e kalojmë atë. Unë thashë, “Kur kam qëndru qe dymbëdhjetë muaj edhe një ditë nuk ka problem”. Ai tha, “Jo, jo mirë osht’ po ta falim edhe këtë ditë por ke kujdes. Ti je paraqit si ushtar shumë i mirë por unë e di që je koka e inteligjencës shqiptare”, tha, “ti je koka e atyre, je ai që n’mesin e atyre që keni organizu demonstratat në Prishtinë dhe koka inteligjencë”. Kur ma përmendi dy-tri herë buzëqesha pak. Thashë, “Po ku marr me qenë kokë, po m’jepni ni privilegj shumë t’madh”, thashë, “se...”, “Ki kujdes”, tha, “se je paraqit shumë i mirë por nëse gabon ki me pësu keq”, thashë, “Unë jam ai që jam”.

U lirova nga shërbimi ushtarak, do të thotë e kreu. Pastaj, vërtetë ka qenë problem për me u punësu për arsye se në arsim nuk lejonin. Me pranë çdo punë ishte pak e, jo e natyrës time. Po megjithatë në konsultim me shokët që bashkëpunonin dhe vepronim ma mirë me qenë i punësun dhe ki mundësi lëvizje dhe ndoshta nuk osht’ përcjellja ma në nivel e tjera. Më ndihmuan shokët, kolegët, vendasit,

kolegët që kishim qenë në studime bashkë sidomos të rrethit. Me i përmend Qazim Hoxha i ndjerë tani, ishte drejtor financiar aty ku m'dërgun me punu. Ni Halië Morina drejtor i ndërmarrjes për ni sektor. Ni Shefki Morina, Mahmut Morina, Milazim Morina që ishin të sektorit juridik.

Ma mundësun në rregulloren e ndërmarrjes, e futën ni nen që ma ndrrun vendin e punës nga administrator e punë të administratës më bon kontrollor të administratës. Merre me mend, nëse shkoja me veturë timen që s'kish veturë aty shpenzimet e veturës m'i paguanin. Nëse merrja veturën e punës kishim punishte në çdo qytet të Kosovës. Në Prishtinë, në Prizren, në Ferizaj, në Gjilan, në Mitrovicë. Mu m'u dha mundësia m'i taku njerëzit që bashkëpunonim, shoktë. Kinse po punoj edhe e vazhdonim aktivitetin.

Derisa ra n'sy ni rast. E takova ni inxhinier serb me ni rast jo t'mirë me ni punëtore serbe aty me ni punishte. E paraqita si rast se po ju them, çdo gja që ishte sllave m'pengonte. Atëherë ai me lidhjet e komitetit që kishin kërkun nga drejtori që ose me ma ndrru vendin e punës ose përgjegjësi drejtori. Drejtori m'thirri, tha, "A je për me m'largu mu prej punës apo... se ne tash me vendim, e kemi vendimin je kontrollor i ndërmarrjes po qishtu osht' puna". Thashë, "Jo more, se ti i ndihmon edhe naj kujt tjetër unë s'prish punë".

Rrogën ma lan njësoj mirëpo vendin e punës ma ndrrun. Në vitin 1990 pastaj kur fillon, pas shpalljes së deklaratës kushtetuese ndryshimeve që bëhen, fillon të punoj arsimi me plan programet e Kosovës, unë drejtohem drejt te shkolla në Malishevë fillimisht te gjimnazi i Malishevës që t'më pranoj me punu si profesor i historisë. Për arsye që nuk e di drejtori ishte ende ai që e kishin caktu dhunshëm aty dhe ndoshta kishte frikë. Po e arsyetoj sot për atëherë megjithëse jo sa duhet. Nuk më pranoj për me punu aty dhe mua më ofroj punë ni ish koleg i imi që e falënderoj sot për atëherë gjithmonë. Ishte drejtor i shkollës profesionale në Kievë, Haki Gashi. Drejtor aty.

Më tha, "Nëse don eja drejtor n'vend timin ose orët e historisë i ke këtu urdhno dhe fillo punën që nesër". Kam fillu me 1990 deri n'fund të vitit 1993. Pastaj bisedova me drejtorin e ri që erdhi në gjimnazin e Malishevës Gani Bajrakun që e kisha mik e shok, kishim kry studimet bashkë. M'tha që, "N'fillim në janar ose shkurt eja fillon këtu se e ki ma afër. Sa udhëton, ma mirë eja këtu". Në shkurt të vitit 1994 kam fillu me punu pastaj në Malishevë. E kisha ma afër shtëpisë dhe ma lehtë ishte për mu. Edhe pse nuk kishte pagë atëherë, nuk kishim pagë. Pat' fillu herë pas here na jepshin nga 40 marka gjermane n'atë kohë. Po ato s'na dilshin as për benzinën. Po kryesorja pagë nuk kemi pasë përveç asaj që filloj me u organizu me ndihmu arsimin. Fillimisht na kanë thanë nga 40 marka gjermane.

Në Malishevë fillova në fund të shkurtit. Me 14 prill të vitit 1994 unë isha në mësim, vjen djali i vogël i motrës, i dhandrrit Avdyl Krasniqit, Kushtrim Krasniqi. Thotë, "Dajë, në mëngjes herët", thotë, "kanë ardhë policia e kanë marrë babën dhe tre vllaznit tjerë ma t'mdhaj", t'u qajhtë. Thashë, "S'ka problem". Ju tregoj që unë duhet me u largu me shku drejt atje me pa se si osht' gjendja te motra. E dijsa që

rrugës ka ende polic. Kom shku në shtëpi, kam marrë babën me vete qysh ishte qashtu. Kinse se nëse m'nalin policia ju thom osht' i smutë edhe p'e çoj ose po shkojmë me marrë barna në barnatore.

E përdornim atë taktikë. Mbanim receta në veturë që kur na ndalnin, "Nuk gjeta barna në Malishevë po shkoj në Kievë", ose e kundërta, "Në Kievë po shkoj në Prishtinë", kur na nalte policia. Babën i thashë, "Shtriju mrapa në karrigat... " kishe osht' smutë e pata te mjeku po shkoj m'i marrë do hapa në Kievë. Se t'u hi në Drenas, fshati t'u hi në Drenas ishin dalë policia te ura. E nalën p'e kqyrin... kta ishin kanë t'u m'lypë normalisht po tash me m'pa kah po shkoj. "Mirë, vazhdo".

Shkova te shpija. Kur shkova shoh çka kishin bo, çfarë thymje gjatë bastisjes. Po m'tregon motra krejt atë tmerrin që kanë përjetu. Thashë, "Ku kanë shku?" Tha, "Nuk e di, i kanë marrë edhe s'e di". Mora veturën qashtu me babën kinse smutë e në Kievë. Në Kievë kisha koleg që janë kanë udbash ni Sami Toplanën. Shkum në odë të tina po i thom, "Gjona ndonjë zgjidhje, pytni në stacion të policisë ku i kanë çu. Kemi pritë aty derisa jemi informu që i kanë çu në Klinë niherë tani në Pejë. Fati që e kanë nalë veç Avdylin se tre djemtë i kanë lëshu. Kta kishin mendu që edhe djemtë... djemtë... personin që e kanë kërku osht' paraqitë me emër tjetër. Kur e kanë lshu mandej kanë thanë si e lëshum, duhet me... ku me gjetë kaq shpejtë. M'i lidhë ngjarjet po flas. Ishte 14 prilli.

Kur kthehem në shtëpi i tregova motrës që, "Avdyli është në Pejtë, djemtë janë të lëshun mos u bo merak". Shkoj në shtëpi. I thom babës e nanës, familjes, shoqes, fmi t'vegjël ishin. "Kujdes se ka mundësi vijnë për çdo rast edhe te na". Do gjana që kisha i largova. Do çka kishim aty literaturës edhe naj cikrrim, naj armë që ishte. Në mëngjes herët të nesërmen dikund nga ora 04:30 ndoshta 05:00 herët shumë, vijnë. Trokisin n'derë. E kanë rrethu lagjen edhe shtëpijen. 40-50 polic të veshur të armatosur ta merr menja që luftë.

Nuk e di. Po të humke frika kur e din se... çka ki me ba kur je në mesin e gjithë atyne. Fillun me kontrollu gjithkah. Më tregun atë urdhërin që kanë për me kontrollu, ma dhanë ni kopje dhe ishin tre civil. Dy shqiptarë, ni serb ose malazez. Udhëheqës kryesor ni Osman Fejza. E disha i kahit osht' e kush osht'. Ai kryesori. Ni Hasan që pastaj e kanë vra pas luftës, Hasan Rustemi m'duket dhe ni Jovica, Jovica ai serbi. Osht' e dhimbshme kur i kujtoj ato rastet kur shqiptarët dojshin m'i thy dhomtë t'u piskat, ai serbi dhe malazezi veç rrinte i qetë dhe shihte se çka po bahet.

Po m'pytë ai, "Ku osht' Atomi?" Ai nipi e kishte emrin Atom, Atom e ka emrin. Unë isha i tmerrum. Atomi nuk lypet nëpër sirtar e vitrina. Atomin lype dikund... thashë, "Ti Atomin po e kërkon a? Ku p'e kërkon në sirtar Atomin? A e din që e kom nip ata? N'grusht me pasë nuk ta jap". Ardianës, vajza ishte e dyta fmi mandej ju kish pasë tregu ktyne kish thanë, "Babi me pasë n'dorë nuk ta jep". Në momentin kur shkojmë babën e kishin lanë në odë. Janë gjana që vërtetë ia vlen, për atë arsye po i përmendi. Se kur i kujtoj rrënqethëm. Nuk kam qef as me i përsërit. Por janë gjana që për ata që nuk e dijnë se çka kemi përjetu osht' shumë interesante të dëgjohen këto.

Kur hymë në odë unë në odë i kam pasë prej Skënderbeut gjitha këto ftyrat e Rilindjes Kombëtare me radhë. Deri te Ibrahim Rugova ishte atëherë kryetar. Fotografi në ram. Ai po thotë tha, “Hajde tash trego shqip çka ke”, tha, “kundër shtetit tonë?” Baba rahmet i pastë shpirti, ndjesë pastë, ishte në kokërr shpinë kamën mi kamë kapelen vazhdimisht e ka pasë me tirqi. U çu edhe i tha, “A shqiptar osht’ ky pis a?” Tekstualisht ksi soji. Thashë, “Po babë shqiptar osht’ Osman”, nuk m’u kujtojke mbiemri Fejza po të fshatit ia thom, “Osman Patoku edhe ky osht’ udhëheqës i ekspeditës”. “A”, tha, “me babën, shtramno kapuçin”, tha, “veç ta di kush po të merr”.

Besoni që kur kemi dalë nga aty u ardhë ma ka ngjit për krahu tha, “Kujdes se po flet shumë randë e kta policia e dijnë shqipen”, se ishin të rrethit të Rahovecit. Nime ishin të Opterushës e kuptohet që e kanë ditë edhe shqipen. Thashë, “Le të shembet”, përdora ni shprehje popullore, “deri kur ra pikë”. E hetova meniherë që u frikësu. M’kanë marrë m’kanë çu në Rahovec. Tanë ditën nuk ka guxu me dalë prej zyres po në zyre t’vet m’ka majtë për arsye se në zyra tjera u dëgjoshin britmat e njerëzve që i rrehshin jo me kërrbaç po kishin marrë drunjë special që i rrihnin. Në koridor u enshin tre-katër polic.

Ai Hasani ai tjetri... se kur i thashë unë, ke edhe ni rast tjetër. Ardiana e vogla ishte me shoqen aty, ishin përpara. Hasani, jo ky kryesori Osmani, tha, “Veç diçka se ki me ardhë me ne. Hajde, hajde”, nifar’ toni si urdhëror. Sa kishim dalë prej dhomës. Vajza po m’duket që po e shoh... ni rast i vajzës time të dytës Ardianës kur polici civil që ishte i veshun edhe ai, Hasan Rustemi. Thotë, “Ec vesh diçka se ki me ardhë me neve”. Para derës të dhomës. Vajza bashkë me gruan time ishin aty, ajo e vogël. I dridhej buza tha, “Babi a po shkon me shokun ton a?” Se ai ishte civil edhe të thom diçka.

Thashë, “Jo me babin se ky osht’ ma i zi se ata policët që na kanë rrethu. Edhe ky osht’ polic”. Atij i erdh inati tha, “Hajt se të tregojmë kur t’çojmë atje”. Thashë, “Drita ju doktë”. Vazhdum pastaj më çun atje. Gjatë tanë ditës përgjegjësi që ishte i ekspeditës ai Osmani, Osman Fejza nuk ka dalë nga zyrja. Kur kemi dalë pak deri në banjo kemi dalë për arsye se frikësohej se mos po më malltreton ai e në anën tjetër baba i kishte thanë ktina, “Tani po e di kush po ma merr”. E hetova që u frikësu nga ajo. Nuk kanë përdorë dhunë fizike përveç asaj që kanë pytë herë njani herë njani. “Lidhjet me Avdylin, pse? Çka keni ba? Ku keni qenë? Tek keni qenë?”

Osht’ e dhimbshme kur e mendoj si kushte mundësi që e dinin për çdo orë e minut ku ka qenë vetura ime. Sot vërtetë teknologjia osht’ dhe ka mundësi përcjelle por atëherë. Atëherë vetëm përmes njerëzve të pa paguar shqiptarëve të zi të cilët janë mashtrur për ni pasaportë ose për hiç kurgjo dhe kanë bashkëpunu. Ku e dinin që në momentin kur kam dalë nga Dragobili në cilin drejtim kam shku. Ku kom kalu te Malisheva. Ku kam hy në cilën shtëpi. Vetëm që nuk kishin qenë me na dëgju edhe...

Anita Susuri: Në dhomë.

Agim Paçarizi: Në dhomë. Ajo me Avdylin ky rasti i fundit që e marrin atë dhe pastaj edhe mua kishte qenë informim nga ni i tyre kur ne jemi taku afër 100 persona në shtëpinë e dhandrrit. Sepse në vitin

‘91, ‘92, ‘93 filloj të mendohej për ni organizim ma të mirë për m’i mbrojtë të drejtat tona. Sepse politika paqësore vërtetë ishte, na orientoj dhe na krijoj mundësi miqësie me të fortët, me SHBA e të tjerët. Por secili e ka ditë, ata që e kanë ditë se kush osht’ Serbia që osht’ e pamundur që të fitohet pa luftë. Ne fillum nifar’ forme me bashkëpunu edhe me njerëz që të organizohemi për ni mundësi që me ni rast të kemi mjete për me përballu.

Ishte atëherë ai fronti, si quhet, ishte kta Jeton Kaçi e këta Mentor Kaçi, Sokol Dobruna e Kadri Osmani, Avdyli. Jemi taku 100 vet afër 100, ndoshta ma pak ose ma shumë po kemi qenë në oborr të atyne u mbush krejt vetura se brenda u dashke me hi. Kemi bisedu aty disa orë, kemi hangër drekë aty. Dikush paska qenë aty. Sigurisht që ka pasë njerëz që ka marrë shënim për secilin kond e ka ditë që kush janë tek janë ata që i ka njoftë, ata që s’i ka njoftë s’i ka njoftë. Tash neve që na kishin njoftë fillun me na marrë. E morën Avdylin. Mu erdhën më morën të nesërmen. Fillun do tjerë m’i marrë në Mirushë, aty ktu do të thotë, në Turajkë.

Ne ishim marrë vesh, siç e përmenda ma përpara, që ne t’familjeve nëse merremi, ne jemi vetëm miq. Sikur për shembull kur m’kanë pytë për Bahrinë, “Mesë e kam. Kam shku atje për me marrë sepse ka ndodhë ngjarja me tërhjekë se mesë e kam, ajo m’ka dajë. Kurfar’ lidhje s’kemi. Nëse unë kam ba diçka jom i vetëdijshëm atë që e kom bo edhe e mbështes ata. Nëse ajo ka bo diçka ajo osht’ e rritun e mbështet”. Kshtu tani edhe ktyne. Se për Avdylin tash m’pytnin. “E kemi marrë këtë, e kemi marrë atë, kemi thënë kështu, kemi thënë ashtu”. “Unë”, thashë, “Avdylin e kam dhandërr. Ai ka motrën time. Axhën e vet e ka pasë smutë”, që shpesh herë e kemi mundu.

Sot thom qysh e kemi mundu. E merrnim për shembull kishim m’u taku dikund e merrshim me veti që kur na nalin policia, ai ishte i vjetër shumë, “Po e dërgojmë te mjeku se ka nevojë për te mjeku”. Shpesh herë e kemi marrë, sot m’dhimet për atëherë. I kom thanë që, “Unë kam shku kam shku me marrë motrën, kam shku me pa motrën, kam shku me marrë me ia kry ndonjë shërbim se s’ka pasë ai veturë me i kry ndonjë shërbim për migjën Ibrahim”, “Mirë mirë ne po presim. Ai po thotë kshtu, ashtu”.

“Urdhno bjerne këtu le t’më thotë mue ose çomni mue le t’më thotë ai mue çka po thuni ju. Unë e di që s’osht’ e vërtetë. Nëse doni me më akuzu mu”, thojsha, “mundeni me më akuzu vetëm që po punoj me plan programet e Republikës së Kosovës. Nuk pendohem për atë për arsye se unë jam i vetëdijshëm për punën që e bëj. Nëse doni, urdhnoni keni fakt. Kjo është e vërteta. Për tjetër gja kot më pytni”. Në fund në mramje, në mramje tha, “Shko në shtëpi por kur t’vijne me të marrë mos rezisto po eja meniherë”, “Hiç”, thashë, “mos eja me më marrë. Veç çom fjalë, unë vi”.

Vet me veti me dalë njëherë nga këtu ma s’keni me m’pa. Se ndërkohë më kujtohen tash ngjarjet. Ni moment e thërret dikush n’telefon. Kumeditë kush paska thanë, “Po e lypin? Qysh e keni marrë?” Mu po më drejtohet tash, në telefon ende, tha, “Ku e morën vesh që t’kemi marrë na kaq shpejtë ty?” Thashë, “Po habiteni?” Thashë, “Ma merr menja që tash edhe Washington e din”. Sepse ishte ajo qendra për informimin e Kosovës, kta gazetarët nga tereni meniherë e lajmëronin lajmin që u arrestu,

u burgos ky. Ata kishin shkrujtë shkrimin që me forca të mdhaja të policisë u arrestu profesori Agim Paçarizi. Si lajm ish shku.

Thashë, “Janë njoftu nuk osht’ për m’u habit”. Po në fund më lshun. Kur dola nga aty ma nuk kam dalë publikisht. Në shkollë shkojsha me vëmendje se ku shkoja dhe vështroja se mos po vijnë policia me u largu dikah. Kanë ardhë edhe niherë mas dy-tri dite me m’kërku me polic. Baba ka thanë, “Ka shku në shkollë”. Unë jom kanë në dhomë t’u u bo gati. Për dritare gati me përgadit me kcy përmbi ato me dalë anena. Gruja ma ka bo me shenjë që prit. Policia kanë mendu që jam shku në shkollë, atje kanë pytë ju kanë thanë, “Jo, s’ka ardhë”. E kom çu vllaun mandej ka kqyrë. I kanë thanë, “Kanë qenë”. E kom njoftu drejtorin, “Ma nuk vi, përfundoni notat boni si të doni. Unë nuk e kam njet me shku në burg të Serbisë”.

Pjesa e Pestë

Agim Paçarizi: Kam qëndru ilegal derisa gjetëm mundësi me dalë jashtë shtetit. Përmes Maqedonisë me vllaun e Bahrisë... edhe këta e kemi, e kem marrë për shembull kufirin me kalu niherë mendum me kalu kah Qafë Thana me thanë që po e çojmë në kontrollë... e pata në Shkup m’kanë thanë me çu në Tiranë. U leju atëherë me kalu. Po tash pashaportën e kisha frikë që mundet me na me verifiku dikush, mund t’jem i regjistrun aty edhe më nalin. Kemi hypë në aeroplan prej Shkupit në Tiranë, merre me mend. S’i kena pasë kushtet kumeditë se çfare po kemi marrë biletën në Shkup Tiranë me aeroplan.

Në Tiranë pastaj me lidhje në Durrës. Prej Durrësit kemi shku në Itali. Itali kemi nejtë ni natë, kemi gjatë ni lidhje kemi pagu 1200 marka me na çu në Gjenevë. Në Gjenevë kemi hy në strehim politik me kërku. Pas dy-tri dite atë e kanë dërgu diku tjetër, mu më dërgun në Kimokiaso dy javë kam qëndru atje e pastaj dy ditë intervistë kam pasë. Intervistë që ta merrte menja janë ma t’rrezikshëm sesa këta udbashët në Serbi. Osht’ interesante me përmend kur kërkonin, insistonin me t’madhe emrat e personave që kam bashkëpunu. Sepse nifar’ forme këto dokumente që kishin shkrujtë shtypi për arrestimin edhe për izolimin atëherë në ‘81-ten po edhe për arrestimin po edhe bastisjen ishin edhe qendra për informim i kishte botu.

Por, tash, “Persona që ke bashkëpunu”. Po gjithë ata persona që ishin aty, unë thashë, “Nuk mundem me dhanë asni emër. Sepse nuk mundem. Jam i betun që mos me tregu njani tjetrin. Për këta që ishin do që kishin dalë, s’osht’ problem, por nuk mundem”. “Mirë”. E ndërprejti intervistën ai që e bënte dhe kur dolëm në pauzë t’u pi kafe, po thotë, në pushim, “Dosja jote osht’ shumë bindëse për me pasë strehimin politik. Por në momentin kur ti nuk bashkëpunon me neve”, i bijke që ti s’po jep t’dhana çka na po t’pysim, “ne jemi të detyruar me përdor këtë nen”, nenin e kishin sipas ligjeve të tyne, “nuk po bashkëpunon s’ke mundësi të strehimit politik”. Thashë, “Në rregull, ju e dini. Vazhdoni procedurat e juaja. Por unë e kam parim për arsye se nuk kam besim sa duhet”.

Ai u ni i prekur tha, “Si s’ke besim? Atëherë pse ke kërku strehim politik në Zvicërr?” Thashë, “Nuk... mos më keqkuptoni po derisa ju ende po dyshoni se çka kemi përjetu ne edhe çka po përjetojmë Serbia me propagandën që ka bo e ka formu këtë bindje te ju që nuk osht’ e vërtetë ajo që po përjetojmë, po thom të përgjithshmen”, thashë, “ku mos me besu unë ose ku mos me u frikësu që ende pa dalë unë nga zyret e juaja osht’ dikush ju që me një të prekne të ni faksi mundet me dërgu në Beograd njerëzit burgosen atje ende pa dalë unë prej objektit këtu”. E kuptoj që po e thom me shumë sinqeritet.

Mirëpo tha, “Po heziton në disa pyetje”, “Po hezitoj”, thashë, “m’duket palidhje po m’pytni për diçka dhjetë, 15 herë për t’njejtën gja”. Aty ia nisi me buzëqesh tha, “Unë e di pse po pys dhjetë 15 herë për ni gja se”, tha, “e vërteta nëse thuhet për 100 herë osht’ e vërtetë. Ajo osht’”, tha, “teknikë e jona”, tha, “po këtu kom rrezik se”, mandej edhe vet ma tha, “derisa nuk po jep emra të bashkëpunëtorëve”, tha, “osht’ pak, nuk jom e sigurt se si kalon dosja ju”. Thashë, “Le t’kalon si t’kalon. Unë jam nisë nga ajo që Zvicrra osht’ ni shtet demokratik dhe kam kërku strehim politik, e juja me vendosë”. Pas ni kohe pastaj më njifet e drejta.

Por e marrin edhe shoqen. Se po harrohen gjanat periudhë shumë e gjatë. E pyesin shoqen time për, “A din me na tregu rastin me na përshkru se kur kanë ardhë me marrë Agimin? Rastin e 15 prillit”. Kjo, gjana që s’harrohen. Thotë, “Si mundem me harru diçka që nuk isha e sigurt që ndoshta po del i gjallë prej oborrit me ton ato forca që e kishin rrethu”, edhe e tregon ngjarjen se si ka ndodhë. Mirë. Mbas ni kohe të rregulltë që i kanë procedurat taman ma njohin strehimin politik. Kur njihet strehimi politik, ju e dini, shteti t’i ofron të gjitha mundësitë e mbijetesës. Unë e gjaj vetën aty në Gjenevë për arsye se kishte ni numër të madh të aktivistëve që kanë punu.

Bile kishte disa që ende nuk kishin mujtë m’u kthy fare në atdhe. Ndër ta është edhe Xhafer Shatri, Sami Dërmaku, Naim Shala e të tjerë do të thotë që kanë qenë, Ramadan Avdiu. Që ma vonë mandej sigurisht e... e gjej vetën... Naim Mala. E gjej vetën në mesin e tyre dhe më jipet mundësia që të kisha strehimin politik, banesën e sigurune, para për ushqim dhe për veshmbathje edhe për telefon na jepnin. Do të thotë i kishim të gjitha në nifar’ forme kushtet mesatare për me jetu ishin. Unë meqë m’kishin largu nga arsimi edhe kisha n’gjak atë mësimdhënien kërkova që të kyçem meniherë po fillimisht ishte pak ndoshta jo bash e sigurt edhe prej atyne atyne se nuk u dike kush po shkon.

Atëherë u shpall ni konkurs në republikën, prej Ministrisë së Arsimit në Republikën e Kosovës se ishte në ekzil. Konkurova dhe caktohem që të punoj si mësimdhënës në Gjenevë bashkë me disa të tjerë. Se konkursi i shpallur pastaj të gjithë ata që kishin konkuru, ata që kishin zgjedhur i kishin publiku pastaj në gazeta ditore se ku jemi caktu dhe kush jemi caktu me punu me fmi shqiptarë. Nga viti 1996 kam punu deri në luftë me fmitë shqiptar si mësimdhënës. Kur filloj lufta jam angazhu për me ndihmu luftën përmes njerëzve, nipave që kisha.

Pastaj e kom pa që kishin qenë edhe si urdhëresë nga shtabi i UÇK-së, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, se mandej ma kanë pru ni dëshmi si veteran, pjesëmarrës i luftës. Kam punu në logjistikë për furnizimin e ushtarëve të UÇK-së këtu me ndihma që mund t'i grumbullonim atje. Unë personalisht e kom sjellë deri në Tiranë ni rast, osht' me përmend, telefonin e parë satelitor për komunën e Malishevës edhe disa radio lidhje, dhjetë dymbëdhjetë radio lidhje. Disa zbulues minash të cilët i kishin ble në bashkëpunim me shokët. I kishim grumbullu mjetet, fillimisht t'u fillu vet e pastaj të tjerët. E që proces verbalet të gjitha i kam. I kam sjellë deri në Tiranë pastaj prej aty i kanë pru në Kosovë.

Sigurisht aty hin njeri që njihet edhe si ushtar ka ardhë me mu bashkë Ilir Mirena që pastaj ka qenë edhe zëvendës ministër, nëse ju kujtohet si emër. Deri në Tiranë kemi ardhë bashkë. Kemi pasë peripeti me kalimin e aeroportit se mjetet i kisha në emër timin edhe na i ndalun po e kaluam. Dy ditë kemi nejtë aty pastaj Iliri ka vazhdu me ushtarët kënde, unë jam kthi për ndihma tjera. Ni rast tjetër kam marrë pjesë me ni, me ni kontigjen të tyre, ni komunës në Francë, përmes ni shoqatës miqësi Francë Shqipëri. Dy kamiona me 30 ton kemi pru ndihma i kemi shpërnda në kohë të luftës në Shqipëri. I kemi sjellë nga atje. Unë kam qenë si shqiptarë i kam përcjellë me ndihmën e ushtarëve të UÇK-së.

Ni nip i imi, Halimi, ishte atje në udhëheqje të policisë ushtarake. Ma mundësun që në gjithë territorin e Shqipërisë të kem lëvizje pa pengesë. I kemi shpërnda ato ndihma. Pastaj herave tjera kur kemi dërgu edhe materiale tjera ka pasë raste që kemi dërgu jelek antiplumb. Kemi dërgu zbulues minash sidomos se për kalimin e kufinit ishte frika që ushtarët binin në mina. Në fund të luftës fatbardhësisht te zvicërranët, te ata që na binte, bisedonim me ta, i çanim hallet me ta dhe flisnim ne çka kemi përjetu në Kosovë që para luftës e dija që nuk besonin sepse propaganda serbe e kishin bo t'vetën. Ishte be pa mundur atyne me ju mbush menjën se ka ni popull sikur ne shqiptarët që jemi në atë gjendje në Jugosllavi.

Jugosllavia kishte ni autoritet t'madh në botë. Pas luftës e hetun ata se çka përjetun gjatë luftës. Sepse ni valë e madhe e fëmijëve, e nxanësve, e njerëzve erdhën edhe atje. E ne si Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë u morëm me sistemin e tyre, përgatitjen... u krijun disa mundësi që të realizoheshin, u thonin klasë të pritjes. Klasë të pritjes sepse i merrnin, ishte kohë e pushimit, i merrnim punonim me ni mësimdhënës në gjuhën frënge dhe ne ni shqiptarë. Bashkëpunonim me ta, i çonim në pishina, rekreacione të ndryshme, vizita u bënë parqeve të ndryshme, shëti, muze e tjera. Për me i largu nga tmerret e luftës.

Mandej, kur pashë që kemi kriju miq, unë në bisedë me disa edhe me kryesinë e Lidhjes së Arsimitarëve të Prindërve Shqiptarë vendosa që t'mos punoj si mësimdhënës po të merrem me organizimin e mësimi klasor. Më caktun pastaj kryetar. Pas luftës me miq që krijum edhe që e panë realitetin pastaj më ofrun ndihmë edhe kërkun nga ne si kryesi e Lidhjes së Arsimitarëve të Shqiptarëve që t'i rihapim klasat. Na premtun që të gjitha mjetet çka janë të nevojshme ju japim ne, veç na jepni dëshmi se sa nxanës keni, sa mësimdhënës jeni dhe sa klasa ju duhen.

E fillum mësimin. Fillun me na dhanë përkrahje materiale. Për gjithë atë punë që është bo pastaj nga viti 2000 deri në 2012-ten kur kam qenë anëtarë aktiv i kryesisë, herë anëtarë herë koordinator i punës në mes të Lidhjes së Arsimitarëve të Prindërve Shqiptarë dhe autoriteteve vendase dhe kryesisë qendrore të Lidhjes së Arsimitarëve të Prindërve Shqiptarë në Zvicërr. Unë me anëtarët e kryesisë së Gjenevës kemi arritë që t'jemi i vetmi kanton në Zvicërr me 26 kantone që t'kemi në vitin 2011-2012 t'kemi ni bugjet të stabël, domethanë, stabil, të plotë që të fillojmë në shtator për mësimin plotësues të gjuhës shqipe.

Për çdo vit na kanë dhanë mjete të mjaftueshme por është dashtë ndoshta me pritë herë pas here s'kemi mujtë m'i pagu me rregull mësimdhënësit. Por na janë ofru mjete për me pagu atë punën që osht' ba. Në vitin 2010-11 e kërkum bashkë me ni zvicrran që na ta kemi ni mbështetje të përhershme. Byroja për Integrim për të huajt në Gjenevë na ofruan nga 10.000 mijë franga që ndaheshin për të huajt neve na ofruan 60.000 mijë franga. Në vitin 2011 unë e kam taku ministrin e arsimit Ramë Bujën në Prishtinë ku edhe i kam kërk me ardhë atje në Zvicërr me u taku me autoritetet atje me e pa, me ju falënderu me nifar' forme për ndihmat që na i kanë dhanë.

Ai ka ardhë në 2011-ten pasiqë Kosova u ba shtet. Sepse deri 2008-ten na u dashke me u thirrë çdo herë kur drejtonim ndonjë kërkesë për të na ndihmuar duhej të kërkonim dhe të thirremi me atë që ne niherë ishim para lufte, në luftë na shkatërroj, tani nuk kemi mjete, s'ka mundësi me na ndihmu shteti nga Kosova ende nuk e kemi shtetin. Kur u bo shteti në 2008-ten u thirrsha në atë që shteti vetëm sa u kriju, osht' e pamundur që t'ketë mjete për mbajtje të arsimit ose mësimi plotësues në gjuhën shqipe. Nifar' forme e arritëm që t'kemi ni buxhet për t'filluar vitin shkollor për t'gjithë ata që dëshironin me viju e vazhdu mësimin plotësues të gjuhës shqipe.

Osht' i vetmi kanton pra që e arritëm me siguru edhe ndihmën financiare. Përveç, përveç asaj që kantoneve të tjera jepnin lokale neve na jepnin edhe ndihma financiare. Për këtë aktivitet që kam ba mandej kam punu pak që mbetët e shkrune kjo, mos të mbetët në harresë. E kam nxjerrë ni libër [tregon librin e tij]. Do ta keni rastin me shfletu nëse ju intereson, e keni. Në pika të shkurta për aktivitetin dhe punën që osht' ba në shkollën shqipe në Gjenevë, kuptohet edhe në Zvicërr. Pas 2012-tes në Kuvendin e Lidhjes së Arsimitarëve të Prindërve Shqiptarë meqë u siguru ni buxhet i sigurt për vijimin e mësimi kërkoja që të emërohen anëtarët e kryesisë nga të rinjtë që ta vazhdojnë punën tonë. U zgjodhën anëtarët e kryesisë të tjerë.

Unë mandej kam vazhdu ta udhëheqi ni shoqatë tjerët të cilën e kishim themeluar krahas kësaj në vitin 1998 në kohën e luftës kryesisht me shqiptarë po në bashkëpunim edhe me vendasit në atë komunë ku punoja une. Shoqata quhet Rrethi Shqiptaro Merinas. Sepse ishte përbëhej prej anëtarëve shqiptarë po edhe të zvicrranëve Merini që ishin aty po edhe të Gjenevës. Nga viti 2012 kam udhëheq atë shoqatë deri në vitin 2020. Në vitin 2018 e kemi ba ni shënim të 20 vjetorit të asaj shoqate ku kanë marrë pjesë ni numër i madh i vendasëve zvicërran dhe autoriteteve zvicrrane po edhe shqiptare.

Ostht'... po kalohet, ndoshta e kalova kur shteti i Kosovës bëhet në 2008-ten. Ne të gjitha shoqatat dhe të gjithë aktivistët që ishim në Gjenevë kena organizu ni program për zvicërranët e kemi qytë, "Faleminderit Zvicërr", "Merci la Suisse". Ku kanë qenë të ftuar edhe ambasadorët edhe vendasit. Aty ka qenë e ftuar edhe Calmy-Rey që ishte atëherë ndër të parat që e njohti Kosovën. E cila me ftesë unë i kam dërgu në emër të kryesisë na është përgjegjë që për shkak të një angazhimi tjetër që ka pasë ma herët të caktun s'ka mujtë me marrë pjesë po na ka falënderu edhe na ka uru. Do të thotë ata janë shumë korrekt.

E kemi dhanë ni program shumë të frytshëm. Me ju tregu edhe atyne që për falënderim, si shenjë falënderimi për t'gjithë ata... si për përkrahje gjatë luftës që kanë pritë shumë të ri e të reja e shumë njerëz që ikën nga lufta po edhe për ndihmën që na kanë ofru neve për punën e shkollës. Sot... edhe te puna ima. Unë si person të cilit ishte njohës i azilit politik e kisha ni kohë ma t'libër me u marrë edhe me aktivitete tjera edhe e kam shfrytëzu atë mundësi sepse fati im bashkëshortja ime është e ka shkollën e mesme të mjekësisë të kryne. Po për hir të fmive që i kishim të vegjël nuk u punësua po u murr me fmitë. Unë u mora me fmitë në përgjithësi, me fmitë ma tepër të shqiptarëve që ishin aty.

Unë e falënderoj çdo herë edhe bashkëshorten se është marrë me fmitë e mi dhe ostht' kujdesë për ta që fatbardhësisht sot kanë kry shkolla dhe punojnë, t'gjithë janë t'rritun. Jam mirënjohës asaj që u marrë me ata. Unë duke u marrë me të tjerët kisha frikë nganjëherë që mos fmitë e mi po devijojnë po fatbardhësisht janë mirë edhe ata. Ostht' kënaqësi shumë e madhe sot që ju me ardhë në Gjenevë, asni të ri shqiptar të ri e të reja të cilët janë në vende kyçe, ka plot jurista, ka plot ekonomista që punojnë nëpër banka, ka profesor, ka mësimehdhënës, ka inxhinier, ka gjyqtar, ka prokuror, ka avokat plot. Të cilët kanë kalu nëpër ato klasët e mësimit plotësues.

Ostht' kënaqësi kur i takon ata edhe e kanë ndërru atë imazhin, atë imazhin e keq që kishte për shqiptarët. Tash nuk pranohet ai imazh i keq që Serbia e kisha shpërnda gjithkah që shqiptarët nuk janë si të tjerët po janë siç na kanë qytë deri edhe me bishta. Është kënaqësi po thom kur i dëgjon ato. Ostht'... unë deri në vitin 2003 jam pajtu me atë që t'jetoj si parazit nifar' forme. Sepse shteti t'i ofron t'gjitha. Merresha me këtë aktivitetin e shkollës dhe nifar' forme nuk e kisha n'kokë paranë që s'e fitoja vet. Po filloj pastaj në 2003-ten e këndej me më shqetësu ajo që pse kur i kam mundësitë pse t'mos punoj që ta fitoj paranë e jo të jetoj si parazit.

2003 në bashkëpunim me Universitetin Popullor që ishte themelu në vitin 1996 falë aktivitetit të shoqatave dhe neve, më ofrun ni zyre të... isha kryetar i Lidhjes së Arsimtarëve të Prindërve Shqiptar... ti ke pasë rast m'duket me qenë atje niherë në vizitë? Ni zyre që me punu në lokale të unviersitetit me pasë lidhje ma të afërt me Lidhjen e Arsimtarëve të Prindërve Shqiptarë. Edhe me ofru ni ditë n'punë n'javë. Ni ditë n'javë me punu për universitetin. Po pastaj unë fillova me kërkua që t'punoj qind për qind. Aty s'kishte mundësi. Më ofrun ni punë në shërbimet kantonale për sigurime sociale në vitin 2007 kam fillu punë si i rregulltë. Në njënin vend ku kishte afër 400 punëtor e asni shqiptar. Shkoj i vetëm me ni moshë goxha të shtyer edhe filloj me punu.

Ata kolegët e punës kur pytshin edhe e shihshin se shqiptarë habiteshin. Se shqiptarët ishin mësu me i pa vetëm nëpër punët e... për qat' ent ku punoja unë. Pas ni kohe fillun me e ndrru atë imazhin që kishin për neve. Sepse kam ba përpjekje në maksimum. Edhe pse nuk ishte e profesionit tim se tani kalova në ni drejtim tjetër. Tani punoja sikur, si punëtor i kontabilitetit. E kisha lanë arsimin. Por, me ni vullnet shumë t'madh, me ni pedantëri shumë t'madhe ju dëshmojsha se edhe ne dijmë me punu sepse aty ishin shumë me kushte, çdo gja që i duhej.

Sot ka aty tash po dëgjoj që janë nja dhjetë 15 shqiptarë. Nga viti 2020 tani jam në pension. Përveç këtij libri jam duke punuar edhe dy-tre projekte tjera, t'shoh sa mundem m'i realizu. Nëse ka ndonjë pyetje që ndoshta nuk e kam thanë ose kam kalu diçka që osht' në interes t'jujin, mundeni me m'pytë...

Anita Susuri: Deshta vetëm pak me ju pytë te aktivizmi që e keni bo, ka qenë viti '97-'98 domethanë. Ka qenë edhe ni grevë që osht' bo atje në Gjenevë, po m'duket në Gjenevë ka qenë...

Agim Paçarizi: Po, po. Ka shumë po për kohën ndoshta... atëherë ishte fillimi i luftës. Filloj lufta. Ju me siguri keni dëgju, në Gjenevë, Gjeneva ka qenë qyteti ku m'duket më së shumti osht' shkelë nga demonstruesit jashtë atdheut aty. Pjesa para ndërtesës së organizmave ndërkombëtarë ku osht' e OKB-së aty me, ndoshta me mijëra herë osht' organizu demonstrata aty. Në vitin 1998 kur filloj lufta, kur lufta zhvillohej këtu ne ni grup aktivistësh në bashkëpunim me të gjitha shoqatat që kanë ekzistuar aty kemi organizu ni demonstratë dy javore. Do të thotë ka qenë dy javë rresht natën dhe ditën demonstruesit kanë qëndru para selisë së OKB-së.

Unë kam qenë në këshill organizativ. Se ne shoqatat e formum këshillin organizativ edhe nga secila shoqatë kishim përfaqësuesit e vet në këshillin organizativ. Shënime ekzistojnë. Ka shënime dhe jemi duke punuar dhe jam edhe vet duke i grumbullu. Pas demonstratës dy javore kemi vendosë me hy ni grevë urie me qëllim që me sensibilizu, me njoftu edhe të tjerët të huajt se në Kosovë po bëhet ni luftë, po bëhet ni gjenocid ku janë forcat e pabarabarta sepse ata ushtarët që kanë dalë, ata ushtarët e UÇK-së janë në të drejtën e tyre, ata po mbrojnë popullatën dhe po luftojnë për vendin e tyre. Greva ka zgjatë shtatë ditë. Shtatë ditë ne kemi qenë në 14-15 veta që kemi qëndru pa ushqime.

Osht' formu ni këshill, ka qenë... prej atyre që na kanë përkrahë dhe na kanë mbështetë. Janë marrë me organizimin e stafit mjekësor me na kontrollu. Se fillimisht ne kemi fillu para selisë së OKB-së pesë gjashtë vet ne që ishim. Unë kom lexu atë letrën që osht' thanë që ne ni grup aktivistësh vendosëm që të hyjmë në grevë urie, kush doni t'na bashkangjiteni. Nja katër pesë vet kemi qenë aty kur kanë ardhë policia. Filloj janari. Ka qenë ni e vitit '98. Filloj policia me pa që diçka nuk osht'... ne e kishim marrë lejën për demonstratën po jo me hy n'grevë urie. Atëherë erdhën na kërkun dokumentet. Leternjoftimet. Ishte ni kohë e ftohtë. Filloj me ra borë. Borë nuk bjen shumë atje po me pak a shumë ni kohë jo e përshtatshme për qëndrim jashtë.

Kur erdhën ata thanë, “Ju nuk keni kushtet as minimale këtu, s’mund të qëndroni. Për me qëndru këtu ju duhet t’keni s’paku ni tendë edhe ekipe të tjera që janë përcjellëse”. Nuk na lanë aty. Prej aty kemi shku me ni lokal te ni kishë protestante na kanë mundësu kemi nejtë dy net aty. Prej atij momenti na prunë bashkë... dikush ni qebe, dikush ni jastak, dikush ata edhe u shtrimë ne u vendosëm aty. Pas dy dite na kanë dërgu në lokalet e Universitetit Popullor Shqiptar. Poshtë e lirun ni lokal. Aty kemi qëndru ni javë ditë, edhe pesë ditë aty. Do të thotë dy këtu edhe pesë ditë aty.

Përveç këtë ujë kemi pi edhe ndoni herë çaj pa... çaj të lulave. Pa hangër asni gja. Mjeku na ka kontrollu vazhdimisht. I formum grupet punuese. Dikush merrej me mediat e huaja, dikush me mediat shqiptare, dikush nga ata jashtë për me organizu ata që vinin me na vizitu. Kanë me lanë e kanë mos me lanë. Po ni javë kemi qenë në grevë urie. Pas ni jave pastaj mjeku na udhëzoj që si të fillojmë me ushqimin ngadalë me supa për shkak se organizimi ni javë ditë pa u ushqy. Kishte fillu ni rraskapitje. Vinin disa aktivistë e shokë që i njihnim ne na kërkonin që ndërpritne se osht’ e ndërgjegjësune dhe bota e njuh se çka po bohet në Kosovë.

Ne meqë hym veç kemi vazhdu. Shtatë ditë, ka pasë besoj edhe shkrime që e kanë përmend aty që jemi përmend. Unë e besoj dhe shumë të tjerët sikur unë e që ka pasë edhe të tjerë që kanë ba edhe shumë e ma shumë se unë. Kjo e imja s’osht’ kurgjo n’krahësim që njoh shumë shokë të mi e dashamirë që kanë ba për këtë vend. Ma e pakta që kemi mujtë me ba. Asniherë s’e kemi mendu, s’e kom mendu e që besoj as ata, që po boj diçka që nesër dikush të thotë që kemi bo diçka. Thjeshtë ne jemi mundu që t’bojmë diçka për t’mirën e këtij vendi. Ia arritëm sa ia kemi arritë.

Anita Susuri: Faleminderit shumë për kontributin edhe për intervistën!

Agim Paçarizi: Faleminderit edhe juve që nuk harroni, nuk na harroni dhe nuk e lini në harresë të kalojnë këto vuajtje dhe këto që janë ba, ato ditë të vështira që sot ju e brezat që vijnë ta kanë lirinë ashtu si e duan. Është kjo ni, është për ta vlerësuar dhe përgëzuar që bëni diçka. Është e mirë që të hulumtoni dhe të gjithë ata mundohuni që t’i kontaktoni sepse ka pasë secili në atë mënyrën e vet shumë prej atyre ndoshta nuk kanë pasë mundësi, aftësi të bëjnë më shumë. Po në atë mënyrën e vet kanë ba diçka për këtë vend.

Anita Susuri: Ju faleminderit!

Agim Paçarizi: Ju faleminderit edhe niherë edhe juve!